



# Koha

www.koha.mk



**Kishat po zbrazen**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3447 · e enjte, 30 gusht 2018

17°C | 30°C

15 DEN

## FORUM

### Evropa



Janë plot humor por dhe njëkohësisht tejet thumbuese një sërë reagimesh, batuta apo dhe barcaleta, krijime të shkurtra dhe plot kuptim që shfaqen e pastaj përhapen në rrjetet sociale. Me bien në sy shpesh, të cilat për veç se ta vënë buzën në gaz shprehin dhe përplot ironi, të vërtetë e reale, për realitetin tonë si-domos ndaj Evropës. Marrin edhe më shumë kuptim këto thumba, që vinë në formë të një folklori modern, sepse mu tani Maqedonia flet shumë për Evropën, integrimet për shkak të referendimit për... Fq.10

## RAJON

### Në kërkim të tri votave për ta rrëzuar Qeverinë

Fq.14

## SPECIALE

### Kur Perestrojka shembi Bashkimin Sovjetik!

Fq.16



## ALARMANTE! SHQIPTARËT TË FUNDIT NË MËSIM

# SHKOLLAT SHQIPE MEZI ARRIJNË TRESHIN!



Asnjë nga shkollat me mësim në shqip, ose të paktën ku mësohet edhe gjuha shqipe, nuk ka arritur të renditet në listën e tre vendeve të para, ku suksesi është mbi notën 4 ose rreth 4. Alarmante është situata në shkollat e Tetovës, pasi mu aty gjendet edhe shkolla me sukses më të dobët në Maqedoni

Fq.6

## Ligji për procedurë penale po pengon PSP-në

Shkup, 29 gusht - Gjithsej 142 të akuzuar janë në lëndët e Prokurorisë Speciale Publike, ndërsa të njëjtit ndiqen për keqpërdorim të pozitave shtetërore apo dyshime se kanë kryer vepra kriminale. Kështu rezultoi Raporti i parë i përkohshëm i OSBE-së për aktivitetet dhe rastet që janë nën kompetencë të Prokurorisë Speciale Publike (PSP) për periudhën nga shtatori i vitit 2015 deri në muajin janar të vitit 2018 e që u

prezantua të mërkurën para Prokurores Speciale, Katica Janeva, prokurorëve tjerë si dhe avokatëve të cilët ishin prezentë në publikimin e Raportit. Mishelle Prins, oficer e lartë për sundimin e të drejtës pranë misionit të OSBE-së deklaroi se për më pak se dy vjet e gjysmë që nga themelimi i PSP-së dhe pavarësisht ndërhyrjeve të konsiderueshme nga institucionet e tjera, janë bërë hapa...

Fq.5





## EDITORIAL

SHKOLLIMI  
I KUSHTËZUAR  
ME PUNËSIM

Emin AZEMI

Orientimi i të rinjve për tu regjistruar nëpër shkolla dhe universitete sikur ka ngelë vetëm barrë e tyre, ndërkohë që profesionalizimi i arsimit nuk po e ka qasjen e duhur nga institucionet përkatëse. Të rinjtë tanë ende hezitojnë të regjistrohen nëpër shkolla profesionale, sepse nuk ndjehen të sigurt nëse nesër do të kenë perspektivë me shkollën e mbaruar. Strategjia e munguar kombëtare e lidhjes së arsimit me ekonominë, gjegjësisht me tregun e punës, vazhdon të krijojë dilema te një pjesë e madhe e popullatës e cila sikur po parapëlqen (dhe po punon në atë drejtim) alternativa jashtë vendit për punësim.

Treguesit e gjendjes në terren nuk janë aspak inkurajues sa i përket absorbimit të fuqisë së kualifikuar punëtore për profile të caktuara, bie fjala, në ndërtimtari, mekanikë precize, agrikulturë, ndërkohë që për çdo vit ngelin të zbrazët qindra vende pa u plotësuar në konkurset e shkollave profesionale. Pra mungon një hallkë që i bashkon interesat dhe nevojat. Mungon një strategji që do ta parandalonte, në njërin anën, largimin masovik të rinjve jashtë vendit dhe në anën tjetër, kompanitë dhe institucionet përkatëse nuk po bëjnë hapa konkret në rekrutimin e kuadrove për nevojat e tyre. Sikur të ndahej një fond i caktuar nga kompanitë që do të merrej me stipendimin e të rinjve, situata do të ndryshojë deri diku. Në këtë drejtim edhe institucionet shtetërore, përmes parave publike, mund të bëhen mbështetës të këtyre ideve. Me fjalë të tjera, arsimit profesional i pa mbështetur në formë bursash, do të vazhdojë të prodhojë kuadro që si synim do ta kenë sërish shkuarjen jashtë vendit.

Një ekonomi është perspektive nëse planifikon kuadro që do t'jënë në krye të projekteve. Por kjo nuk mund të bëhet pa një strategji të mirëfilltë. Ëndrra e të rinjve të diplomuar nuk duhet të jetë mësimi i gjermanishtes për tu punësuar në ndonjë Mc'Donalds në Gjermani. Por, shkollimi i tyre te ne ende nuk po kushtëzohet me punësim në vendlindje. Në cilën shkollë profesionale trokitën menaxherët e ndonjë kompanie për të ndarë bursa për nxënës, të cilët nesër mund të punësohen në kompaninë e tyre? Në anën tjetër, edhe Ministria e Arsimit, bashkë me dikasteret tjerë duhet të shqyrtojë strategjinë e bashkëpunimit në mes të shkollave dhe ekonomisë, duke krijuar edhe fonde financiare për një numër të konsiderueshëm nxënësish a studentësh.

Vetëm me hapa konkretë mund të përmbysim këtë realitet të zymtë që për çdo ditë po ua vretë shpresat të rinjve. Ekonomia e Maqedonisë mund të mos jetë gjithaq e fuqishme për të bartë barrën e gjithë zhvillimit social në vend, por ajo, të paktën, do të duhej të orientohet në degë perspektive që mund ti gjejë në arsimin profesional. Nëse shumë kuadro po shkojnë dhe po e gjejnë veten në kompani të ndryshme nëpër botë, kjo të jep të kuptosh se te ne nuk mungojnë resurset dhe kapacitetet profesionale, por mungon një strategji që ato resurse të angazhohen në ekonominë vendore.

Tash më kur janë hartuar programet studimore nëpër universitet dhe drejtimet nëpër shkolla të mesme, mbase është vonë të shpikët ndonjë risi, por mbetet i palëkundur konstatimi se ekonomia vendore nuk vuan gjithaq nga investimet e jashtme dhe të brendshme, sa vuan nga një profilizim më adekuat me kuadro që do të ishin të konkurrueshëm në tregun e punës, me ide e vizione që tash më i kanë kolegët e tyre nëpër gjigantet ekonomike e industriale të botës.

## PSE (NUK) E DËSHIROJNË, AQ SHUMË SHQIPTARËT LIRINË?

"Shoqëritë gjithandaj shqiptare, prej filleve të erërave të demokratizimit janë infektuar aq shumë me zvetënimin e rolit të qytetarit, sa që sot pas gati dy dekadave të testimit të vetvetes për (pa)pjekurinë e tyre, kanë ardhur në një pozicion, sa absurd (sepse, janë bindur gabimisht, se janë në rrugë të duhur), aq edhe naiv (sepse, kanë investuar më shumë në formë; legjislacione e norma kushtetuese, se sa në përmbajtje, pra, në; edukim dhe arsimim të qytetarit). Ky keqkuptim, i fuqizuar me aplikativitet masiv ka prodhuar një "fotosintezë" të deformuar dhe improvizuese sociale, për demokracinë dhe raportet demokratike brenda sistemit vleror mbindërtues...

I gjithë ky deformitet i (pa)vetëdijshëm, dy dekadash është "ushqyer" dhe mbërthyer nga shumë faktorë tjerë të jashtëm të përcaktuar nga kultura masive, arti masiv, politika masive, tjetërsimi masiv, vetëkënaqësia masive, hedonizmi masiv...

Tani, këtë gjendje (frikohem edhe me dromca sindrome!) të turbullt padyshim, në sytë e publikut ende të papjekur sa duhet për "odisejadat dhe betejat" e reja të "pushtimit" të lirive të: qarkullimit të lirë, mendimit të lirë, gjykimit të lirë, tregtisë së lirë, etj., na duhet ta shërojmë me idenë e lirisë pozitive...

Që nënkupton, lirinë jo në vetvete, jo të huajsuere, por "lirinë për diçka" që kërkon rikthim nga gjendja "që posedojmë... "në gjendjen" që jemi".

Kjo gjendje, që për popujt dhe vendet tjera të botës perëndimore, shpesh herë ishte edhe vetë "ferri" i emancipimit, por, edhe caku i asaj që shquhet dhe identifikohet si shoqëri shëndetmirë, ku, arsimit, shëndetësia, mediat, politika, kultura, etj. rrezatojnë liri pozitive, liri kreative kulturore vetanake dhe në mënyrë të pavarur.

Pra, liria tillë nuk është "produkt", që mund të konsumohet, sikurse çdo mall tjetër në tregun e jashtëm masiv. Ky tip lirie, as nuk mund të konsumohet (ashtu siç po mendojnë elitat aktuale; politike kulturore), as nuk mund të amputohet (sikurse; veshja, ushqimi, etj.), nga të tjerët!", shkruan në profilin e tij në FB, sociologu kosovar, Fadil Maloku.

## KUSH E KTHEN SHPRESËN

"Me luftën kundër imperializmit, po kulmon imperializmin.

Me gjuhën antidiktatoriale, po forcohet diktatura.

Me retorikën e privatizimit, po zhvillohet centralizimi i ekonomisë.

Me gjuhën e lirisë, po robërohen popuj.

Me retorikën e internacionalizmit, po forcohen nacionalizmin e tyre duke mos të lejuar as me shku atje nëse gjuhën nuk e di, sepse janë nacionalistë.

Me gjuhën e këshilltarit, po ushtrohet diktaturë.

E populli i shkret shan prindërit e vet, shan historinë e vet, shan vendin e vet, shan kulturën e vet. Sepse i duken të prapambetura!. Mjerim në humbjen e shpresës. Kush e kthen shpresën, ai ka kryer detyrën", shkruan në profilin e tij në FB, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

## KUSH ISHTE LUIXHI UGOLINI?

Luixhi Ugolini ishte arkeolog italian. Kryesoi misionin arkeologjik italian të krijuar më 1926. Misioni do të kryente për një afat prej 30 vjetësh kërkime e gërmime arkeologjike në krejt territorin shqiptar, me përjashtim të prefekturave të Shkodrës, Durrësit e Vlorës. Luixhi Ugolini i filloi gërmimet po atë vit në Finiq, por meqë nuk dhanë rezultatet e pritura,

më 1928 u shpërngul në Butrint. Me gërmimet e bëra deri më 1937 zbuloi një pjesë të qendrës së qytetit, ku ishte ruajtur teatri, një portik, tempuj e godina të tjera, si dhe mure rrethuese etj. Botoi tre vepra të titulluara "Shqipëria antike", ku dy vëllime ia kushtoi gërmimeve të Finiqit dhe Butrintit, duke lënë një informacion të hollësishëm mbi këto dy qytete.

## MEDIACitate

SIKUR PRESHEVA,  
EDHE TETOVA  
MUND TA KËRKOJË  
BASHKIMIN ME  
KOSOVËN

A mund të zgjidhet konflikti ndërmjet Serbisë dhe Kosovës nëpërmjet një shkëmbimi terrioresh? Ish-përfaqësuesi i veçantë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ballkanin, Carl Bildt, ka thënë, në një intervistë për gazetën gjermane Frankfurter Allgemeine Zeitung, se e konsideron këtë ide si iluzion. Sipas Bildt, është iluzion të mendohet se mund të ketë shtete monoetnike. Shkëmbimi i një zone në veri të Kosovës, me zonën e Preshevës dhe Bujanovcit, në jugun e Serbisë, do të prekte dhjetëra mijëra njerëz, ka thënë Bildt. I pyetur nëse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vučić, seriozisht duan një shkëmbim të tillë, Bildt ka thënë se po dëgjon "gjëra kundërtëne". Sa më shumë detaje të ketë, aq më i vështirë bëhet realizimi i një plani të tillë, ka thënë Bildt për FAZ. Bildt ka vlerësuar se "sistemi politik në Kosovë është shumë i përçarë, dhe se është e vështirë të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës një plan që përfshin shkëputjen nga Kosova të veriut të saj". Sipas Bildt, fakti se Uashingtoni dhe pjesërisht Bashkimi Evropian po e aprovojnë një zgjidhje të tillë, apo nuk po e kundërshtojnë atë, i inkurajon të gjithë politikanët në rajon, të cilët ëndërrojnë të krijojnë shtete monoetnike. Por, ai ka thënë se dyshon fort se Amerika e sotme, qëndrimi i së cilës për Ballkanin (jo ndryshimeve të kufijve dhe jo shteteve monoetnike) më s'është i garantuar, do të donte të merrte përgjegjësinë për pasojat e politikave të saj. Kjo, sipas Bildt, do t'i lihet Evropës, e cila, ka vlerësuar ai, "fatkeqësisht është joaktive në raport me këtë çështje". Bildt ka thënë se nuk beson që është realiste që pasojat e një shkëmbimi territorial mund të izoloohen. Sipas tij, nëse Presheva mund të bëhet pjesë e Kosovës, të njëjtën gjë mund ta kërkojë dikur edhe Tetova e Maqedonisë.

(FAZ, 29 gusht)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## KUSH ISHTE LUIXHI UGOLINI?

Luixhi Ugolini ishte arkeolog italian. Kryesoi misionin arkeologjik italian të krijuar më 1926. Misioni do të kryente për një afat prej 30 vjetësh kërkime e gërmime arkeologjike në krejt territorin shqiptar, me përjashtim të prefekturave të Shkodrës, Durrësit e Vlorës. Luixhi Ugolini i filloi gërmimet po atë vit në Finiq, por meqë nuk dhanë rezultatet e pritura,

më 1928 u shpërngul në Butrint. Me gërmimet e bëra deri më 1937 zbuloi një pjesë të qendrës së qytetit, ku ishte ruajtur teatri, një portik, tempuj e godina të tjera, si dhe mure rrethuese etj. Botoi tre vepra të titulluara "Shqipëria antike", ku dy vëllime ia kushtoi gërmimeve të Finiqit dhe Butrintit, duke lënë një informacion të hollësishëm mbi këto dy qytete.



SOT NË KLUBIN E DEPUTETËVE HAPJA ZYRTARE E FUSHATËS

# NIS KOALICIONI PËR MAQEDONI EVROPIANE

“Fushata do të jetë e kombinuar, pjesëtarët e koalicionit pro Referendumit do të kenë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet veti, deputetët do të jenë aktiv pro referendumit, por dhe partitë politike do të jenë në terren që të ndihmojnë fushatën për një Referendum të suksesshëm”, thonë burimet qeveritare për gazetën KOHA



## META: REFERENDUMI I SUKSESSHËM KONFIRMON FITOREN E FORCAVE PROEVROPIANE

Integrimi i rajonit në BE dhe në NATO është shumë i rëndësishëm dhe vital për të ardhmen, thotë presidenti shqiptar Ilir Meta në intervistën për "Albanian Daily News" duke iu përgjigjur pyetjes lidhur me referendumin në Maqedoni. "Maqedonia për momentin është në një moment të favorshëm dhe optimist pas zgjidhjes së kontestit me Greqinë. Pa hezitime ne e kemi mbështetur dialogun mes Athinës dhe Shkupit, duke qenë të bindur kjo është rruga e duhur për të lëvizur përpara dhe për të gjetur zgjidhje për integrimin e Maqedonisë", tha mes të tjerash Meta. Sipas tij, faktori politik

shqiptar në Maqedoni ka pasur rol të pazëvendësueshëm në procesin e transformimit të brendshëm social dhe politik, si dhe për integrimet e Maqedonisë në organizatat euroatlantike. Meta është i mendimit se referendumi i suksesshëm do të konfirmonte fitoren e të gjitha forcave politike të cilat janë të orientuara drejt Evropës. Meta gjithashtu ju bëri thirrje shqiptarëve të Maqedonisë që të marrin pjesë në referendumin e 30 shtatorit dhe të votojnë "pro" marrëveshjes me Greqinë, e cila sipas tij, do të hapë kapitull të ri të integrimit të Maqedonisë.

Paraprakisht është punuar për një takim të përbashkët mes përfaqësuesve të partive në pushtet të mërkurën në mbrëmje, për ti harmonizuar idetë, qëndrimet për formën e organizmit të fushatës. Ndryshe, sa i përket fushatës të diktuar nga Parlamenti, siç kanë njoftuar shërbimet parlamentare, 71 deputetë janë paraqitur për fushatën pro Referendumit.

Shërbimet parlamentare po ashtu thonë se deputeti Antonio

Milloshoski si deputet individ ka dërguar shkresë se do të marrë pjesë në fushatë me qëndrim bojkotues, për arsye se është kundër pyetjes së Referendumit. Ndërkaq deputetët e VMRO-së nuk janë paraqitur të jenë pjesë e fushatës për Referendumin, me çka dhe nuk do të gëzojnë mjete nga buxheti prej 1 milionë 300 mijë euro dedikuar enkas për fushatën për Referendumit. VMRO mban qëndrimin që këto mjete të shkojnë në investime

kapitale. Kjo parti nuk do të bëjë thirrje për bojkot, por do të bëjë fushatë të ashpër kundër Marrëveshjes me Greqinë.

Nga ana tjetër, partitë shqiptare opozitare - Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqiptarët do të bëjnë fushatë partiake secila në vetë dhe nuk pritet një bashkëpunim mes tyre apo një koalicioni i përbashkët pro Referendumit njëjtë si partitë në pushtet. Kështu politike e këtyre dy partive do të jetë pozitive në

raport me Referendumin, konkretisht në interesin e Maqedonisë për të qenë pjesë e NATO dhe BE-së, por do të jenë kritike në raport me një pjesë të Marrëveshjes për emrin me Greqinë që ka të bëjë me gjuhën dhe identitetin kombëtar. Kjo, bazuar në prononcimet e dy liderëve Ziadin Sela i ASH-së dy ditë më parë, dhe Bilall Kasamit të LB-së dy javë më parë.

"Po ne do të jemi pjesë e fushatës pro Referendumit me partitë tjerë në pushtet", e konfirmon kështu për gazetën KOHA pjesëmarrjen në koalicionin Orhan Murtezani nga BESA e Afrim Gashit. Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes BESA e Kasamit, Arjanit Hoxha, thotë për gazetën KOHA se partia e tij do ta bëjë vetë fushatën për Referendumin. "Ne jemi pro Referendumit, kemi kontakte dhe komunikim, mirëpo fushatën pro Lëvizja BESA si parti opozitare do ta bëjë vetëm përmes strukturave partiake. Qeveria ka koalicionin e saj qeveritar dhe ata duhet veçmas të prononcohen se si do veprojnë për Referendumin", thotë Hoxha. Nga Aleanca për Shqiptarët, nënkryetari i saj, Elmi Aziri, thotë se partia e tij mban qëndrim pozitiv për Referendumin në kuptimin e asaj se është mirë të kalojë në një moment të rëndësishëm politik që po kalon Maqedonia. Sa i përket fushatës, shton Aziri, tani për tani nuk mund të themi asgjë pa mbajtur mbledhje Kryesia Qendrore.

"Sigurisht që nuk bëhet fjalë të jemi pjesë e koalicionit qeveritar pro Referendumit. Shumë shpejtë Kryesia Qendrore do të mbajë mbledhje dhe vetëm pas kësaj do të dihet qëndrimi jonë rreth fushatës për Referendumin", thotë Azirisë.

DANIELSON BËN THIRRJE PËR VOTIM MË 30 SHTATOR

## REFERENDUMI PËR TË ARDHMEN E GJENERATAVE QË VIJNË

Shkup, 29 gusht - Më 30 shtator, qytetarët do të bëjnë zgjedhjen e cila do ta formojë të ardhmen e vendit tuaj dhe kjo zgjedhje do të ketë pasojë për gjeneratat e ardhshme. U bëj thirrje ta shfrytëzoni të drejtën tuaj demokratike dhe të votoni në referendumin në vijim. Këtë e deklaroi drejtori i Drejtorisë për Zgjerim dhe Politikë Fqinjësore të Komisionit Evropian, Kristian Danielson, në hapjen e serisë së dialogjeve me qytetarët "Paramendo të ardhmen së bashku".

Ai dërgoi urime deri te kryeministri dhe deri te institucionet e Maqedonisë për arritjen e Marrëveshjes me Greqinë për zgjidhjen e çështjes së emrit që, sipas tij, e hap



rrugën e vendit drejt Evropës. Në lidhje me fillimin e fushatës të Delegacionit të KE-së në Maqedoni,

Danielson tha se qytetarët janë në thelbin e kësaj ideje, por, siç tha, vetë barrën që të zbatohen këto

dialogje të vërteta e kanë komunat të cilat duhet të sigurojnë kushtet e vërteta duke u ballafaquar me problemet reale të qytetarëve.

Kryeministri Zoran Zaev në fillim e fushatës tha se kjo nuk është fushata e parë por as e fundit e BE-së në vend dhe është njëra nga seria e fushatave me të cilën miqtë dhe partnerët tanë evropianë na përkujtojnë se kemi të tashme të përbashkët të cilën e ndërtojmë tashmë dy dekada në rrugën e anëtarësimit tonë të plotë në BE.

"Republika e Maqedonisë e bëri zgjedhjen. Zgjedhi të ardhmen në vend të izolimit të pasigurt dhe të pakuptimtë. Për herë të parë në historinë e saj Maqedonia u ul

në tavolinë si partner i barabartë që të negociojë dhe të vendosë për të ardhmen e saj. Kjo deri më tani nuk kishte ndodhur. Për të ardhmen e saj vendosej pa praninë e saj. Ne thamë jo, për ne dhe për të ardhmen tonë do të bisedoni me ne", tha Zaev. Ai theksoi se përkundër kërcënimeve shfaqën guxim, dinjitet dhe qëndrim politik dhe se pranimet pastaj erdhën edhe si datë për negociatën dhe si ftesë për procesin e përfunduar për anëtarësim drejt NATO-s. Zaev përkujtoi se si fond për fondin para integritit nga viti 2007 deri në vitin 2020 ndihma e përgjithshme vjetore nga BE-ja për Maqedoninë është mbi 90 milionë euro.



ANKETA E IRI-T TREGON RITJË TË PËRKRAHJES PËR ANËTARËSIM NË NATO DHE BE

# SHUMICA PËR REFERENDUMIN

Gjithsej 57 për qind "tërësisht e përkrahin" ose "deri diku e përkrahin" (20 për qind) propozimin që Maqedonia të anëtarësohet në BE dhe NATO nën emrin e ri "Republika e Maqedonisë së Veriut". Numri i njëjtë (57 për qind) besojnë se përfitimet e anëtarësimit e arsyetojnë pranimin e emrit të ri.

Shkup, 29 gusht - Instituti ndërkombëtar republikan "IRI" ka realizuar sondazh në prag të referendimit të 30 shtatorit për marrëveshjen me Greqinë. Sondazhi i ri kombëtar për Maqedoninë tregon rritje të nivelit të optimizmit dhe përkrahjes për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe Aleancën Veriatlantike (NATO) para referendimit të 30 shtatorit. Sondazhi i IRI-t tregon se shumica e qytetarëve të Maqedonisë janë për zgjidhjen e kontestit për emrin me Greqinë. Gjithsej 57 për qind "tërësisht e përkrahin" ose "deri diku e përkrahin" (20 për qind) propozimin që Maqedonia të anëtarësohet në BE dhe NATO nën emrin e ri "Republika e Maqedonisë së Veriut". Numri i njëjtë (57 për qind) besojnë se përfitimet e anëtarësimit e arsyetojnë pranimin e emrit të ri. Gjysma e të anketuarve (49 për qind) kanë ndërmend të votojnë "për" zgjidhjen e kontestit për emrit, krahasuar me 22 për qind që do të votojnë "kundër" ndryshimit të propozuar. "Ashtu siç Maqedonia po i afrohet këtij referendumi të rëndësishëm, përkrahja për një zgjidhje që paraqet kompromis për konte-



## MBËSHËTJETJE EDHE PËR MARRËVESHJEN ME BULLGARINË

Shumica e qytetarëve të Maqedonisë kanë qëndrim pozitiv për Marrëveshjen për fqinjësi të mirë dhe miqësi me Bullgarinë, tregon sondazhi i Institutit Ndërkombëtar Republikan - IRI. Marrëveshjen midis Maqedonisë dhe Bullgarisë e mbështesin 52 për qind e të anketuarve, nga të cilët 24 për qind janë përgjigjur se ajo është tërësisht

pozitive, ndërsa 28 pjesërisht. Marrëveshjen nuk e mbështesin 34 për qind, ndërsa prej tyre 14 për qind kanë thënë se është e pjesshme, ndërsa 20 për qind tërësisht negative. Gjashtë për qind e të anketuarve aspak nuk kanë dëgjuar për marrëveshjen, ndërsa shtatë për qind kanë refuzuar të përgjigjen.

stin për emrin që hap dyert për anëtarësim në BE dhe NATO tregon preferenca të forta për institucionet transatlantike", thotë Pol Mekarhi, ushtrues i detyrës drejtor rajonal i IRI-t për Evropë. "Përkrahja për anëtarësim në BE dhe NATO vazhdon të rritet. Numri i atyre që janë në favor të anëtarësimit të Maqedonisë në BE u rrit në 83 për qind - rritje prej 6 për qind në krahasim me gushtin e vitit 2017

dhe rritje prej 11 për qind në krahasim me marsin e vitit 2017. Përkrahja për NATO-n është gjithashtu e lartë me 77 për qind", thuhet në njoftimin e IRI-t.

Sondazhi gjithashtu reflekton një trend të vazhdueshëm të optimizmit të rritur dhe perceptimit të stabilitetit kombëtar. Tridhjetë e shtatë për qind të të anketuarve mendojnë se vendi është duke lëvizur në drejtimin e duhur - rritje prej 10

për qind prej gushtit të vitit 2017 dhe rritje prej 23 për qind prej marsit të vitit 2017. Perceptimi i stabilitetit është gjithashtu i lartë: numri i të anketuarve që mendojnë se Maqedonia është më stabile sot se para një viti (37 për qind) tejkalon numrin e atyre që besojnë të kundërtën (25 për qind) për herë të parë në gati se nëntë vite.

Ky sondazh u zhvillua për Qendrën për hulumtime të sondazheve

## KRYESON LSDM DHE BDI

Në qoftë se sot do të mbaheshin zgjedhje parlamentare, për LSDM-në do të votonin 21 për qind e qytetarëve, ndërsa për VMRO-DPMNE-në 18 për qind, tregon anketa e Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI). BDI-ja ka mbështetje prej shtatë për qind e të anketuarve, Aleanca për Shqiptarët dy, ndërsa PDSH-ja dhe të dy krahët e Besës nga një për qind. Nëntëmbëdhjetë për qind nuk e dinë ose ende nuk kanë vendosur se për kë do të votonin, katër për qind nuk do të dalin në zgjedhje, ndërsa 23 për qind kanë refuzuar t'i përgjigjen anketës. Në krahasim me anketën e fundit të IRI-t nga gushti i vitit 2017, rejtingu i LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së është rritur për një për qind, i BDI-së dhe PDSH-së ka mbetur i njëjtë, ndërsa i Besës dhe Aleancës për Shqiptarët është zvogëluar për tre për qind.

nga GfK Skopje, firmë për hulumtim të tregut. Të dhënat janë mbledhur prej 28 qershor deri 15 korrik 2018, nëpërmjet intervistave ballë për ballë nga profesionistë të trajnuar. Mostra përbëhet nga 1100 të anketuar, të moshës 18 e më shumë. Shkalla e përgjigjes ishte 69 për qind. Ky hulumtim u zhvillua me përkrahjen të Agjencisë së ShBA-ve për zhvillim ndërkombëtar.

2018, DYFISHOHEN RITMET E PLAKJES

## Shtimi i popullsisë, kthim në vitet e mbrapshta

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, shtimi i popullsisë është thujse dy herë më i vogël gjatë këtij vit. Ajo që bie në sy këtë vit janë shifrat e reduktuara të shtimit natyror të popullsisë edhe në ato komuna që kanë qenë prej disa vitesh në vend të parë. Tetova, për shembull gjatë tremujorit të dytë të këtij viti renditet e dyta, pas Komunës së Çairit (140 persona) sa i takon shtimit të popullsisë, me vetëm 136 persona, pas saj vjen Saraji dhe më poshtë Studenicani

Koha

Evis HALILI

Shkup, 29 gusht - Shtimi natyror i popullsisë ka pësuar një kthesë drastike gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, ku janë regjistruar një numër i vogël lindjesh e kurorëzimesh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, shtimi i popullsisë është thujse dy herë më i vogël gjatë këtij viti, që do të thotë se nëse një vit më parë popullsia është shtuar me 872 persona, këtë vit shtimi i popullsisë mezi arrin në 477 persona.

Viti 2018 në përgjithësi ka nisur me ritme negative. Duke iu referuar të dhënave zyrtare nga muaji janar e deri në fund të muajit qershor, mesatarja e shtimit natyror të popullsisë është vetëm 300 persona ose shumë herë më e vogël sesa gjashtë mujori i vitit 2017. Ajo

që bie në sy këtë vit janë shifrat e reduktuara të shtimit natyror të popullsisë edhe në ato komuna që kanë qenë prej disa vitesh në vend të parë.

Tetova, për shembull gjatë tremujorit të dytë të këtij viti renditet e dyta, pas Komunës së Çairit (140 persona) sa i takon shtimit të popullsisë, me vetëm 136 persona, pas saj vjen Saraji dhe më poshtë Studenicani. Të dhënat janë alarmanante për shkak se ky është viti i dytë me radhë që ritmet e shtimit të popullsisë jo vetëm që nuk janë përmirësuar, por vazhdojnë të thellojnë hendekun çdo vit. Viti 2017 po ashtu karakterizua nga një bilanc negativ, si për numrin e zvogëluar të lindjeve, por edhe për shifrat në rritje të rasteve të vdekjes, divorceve.

"Numri i fëmijëve të lindur

gjatë kësaj periudhe krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë është ulur me 6,3 për qind (gjithsej 5160 fëmijë), numri i persona të vdekur është rritur, ndërsa numri i kurorëzimeve është reduktuar me 1,4 për qind", thuhet në analizën e ESHS. Komunitat që kanë ndikuar në reduktimin e ndjeshëm të shifrave të shtimit të popullsisë janë ato maqedonase ku popullsia jo vetëm që nuk shtohet, por pakësohet. Komuna e Manastirit, për shembull është tkurrur me 94 banorë më pak, si edhe Koçani, Kavadar, Novo Sella, Kisella Voda, apo Velesi. Pesë rajonet ku popullsia po tkurret nga viti në vit janë Pellagonia, popullsia e së cilës vetëm gjatë vitit të kaluar numëroi 920 persona më pak, rajoni Lindor me minus 488, ndërsa shtimi pozitiv i popullsisë është në rajonin e Shkupit me

një mesatare prej më shumë se 2000 persona. Karakteristike për Maqedoninë është se shtimi i popullsisë ndodh në zona rurale, më shumë sesa në ato urbane.

Në nivel nacional mesatarja e shtimit të popullsisë nuk e kalon shifrën 415 persona në qytete, ndërsa në fshatra arrin deri në 1021 persona. Sipas demografëve shifrat negative ndikohen mbi të gjitha nga emigrimet. Duke iu referuar lindjeve të shtetasve nga Maqedonia jashtë vendit supozohet se vetëm vitin e kaluar janë regjistruar pesë mijë të sapolindur në vende të ndryshme të botës. Për shembull, 570 fëmijë me prindër nga komuna e Gostivarit janë lindur jashtë vendit, 286 fëmijë me prindër nga Tetova po ashtu kanë lindur jashtë vendit, 330 nga komuna e Strugës, e të tjera.



OSBE PUBLIKOI RAPORTIN E PARË PËR PUNËN E PROKURORËVE SPECIAL

# LIGJI PËR PROCEDURË PENALE PO PENGON PSP-në

"Si mundet të caktohen 55 seanca gjyqësore nga Gjykata Themelore Shkupi 1 për të akuzuarit e rastit 27 prilli, ku u sulmua Parlamenti i Maqedonisë, ndërsa për lëndën vëllimore siç është 'Titanik', deri më tani të caktohet vetëm një seancë", u ankua Janeva, ndërsa OSBE rekomandoi të ndryshohet Ligji për procedurë penale

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 29 gusht - Gjithsej 142 të akuzuar janë në lëndët e Prokurorisë Speciale Publike, ndërsa të njëjtit ndiqen për keqpërdorim të pozitave shtetërore apo dyshime se kanë kryer vepra kriminale. Kështu rezultoi Raporti i parë i përkohshëm i OSBE-së për aktivitetet dhe rastet që janë nën kompetencë të Prokurorisë Speciale Publike (PSP) për periudhën nga shtatori i vitit 2015 deri në muajin janar të vitit 2018 e që u prezantua të mërkurën para Prokurores Speciale, Katica Janeva, prokurorëve tjerë si dhe avokatëve të cilët ishin prezentë në publikimin e Raportit.

Mishelle Prins, oficer e lartë për sundimin e të drejtës pranë misionit të OSBE-së deklaroi se për më pak se dy vjet e gjysmë që nga themelimi i PSP-së dhe pavarësisht ndërhyrjeve të konsiderueshme nga institucionet e tjera, janë bërë hapa të rëndësishëm drejt sigurimit të përgjegjësive për veprat penale që kanë të bëjnë me përgjimet dhe që u zbuluan përmes skandalit të publikuar nga LSDM.

"PSP-ja arriti të parashtrijë 20 aktakuza brenda afatit të ngushtë ligjor dhe të gjitha aktakuzat u miratuan. Megjithatë, procesi i miratimit mori një kohë të konsiderueshme. Shumë aktakuza që u parashtruan në fund të qershorit të vitit 2017 u miratuan pesë-gjashtë muaj më vonë, ndërmjet nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2017. Meqenëse se Ligji për procedurë penale nuk e përcaktoi afatin kohor brenda të cilit duhet të miratohet aktakuza, mund



të konsiderohet se koha ndërmjet parashtrimit dhe miratimit është tepër e gjatë dhe kjo ka krijuar një perceptim sa ka anshmëri kundër PSP-së nga ana e gjykatës", tha Prins.

Pikërisht vonesa e miratimit të aktakuzave nga gjykatat në mënyrë direkte kanë ndikuar në të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe se ky fenomen është veçanërisht shqetësues për rastet për të cilat vjetërsia absolute do të përfundojë së shpejti.

"Në lidhje me zbatimin e masave parandaluese, Gjykata ka qenë e kujdesshme që paraburgimi të shqiptohet vetëm si mjet i fundit në rastet e PSP-së. Megjithatë, ekziston përshtypja se zbatohen standarde të ndryshme kur bëhet krahasimi me rastet që nuk janë të PSP-së, e në të cilat paraburgimi është caktuar shumë shpesh. Përveç kësaj, është vërejtur se gjatë arsyetimit të vendimeve në lidhje me masat parandaluese, shpesh nuk është marrë parasysh kërkesa për dyshimin e bazuar. Rastet 'Trust' dhe 'Fortesa-Target' e nxorën në shesh një mangësi në kornizën e LPP-së që e rregullon zbatimin e paraburgimit deri në shqyrtim të ankesës, kur paraburgimi është shqiptuar për herë të parë nga Këshilli sipas nenit 25 të LPP-së që ka vendosur në shkallë të dytë", deklaroi Prins. Pikërisht me këtë nen, u shpreh Prins, LPP lë hapësirë për mundësinë që i dyshuari të ikë, të manipulohet me provat ose ta përsërisë veprën penale deri në shqyrtim të ankesës.

"Përkundër arritjeve të suksesshme nga PSP-ja deri më tani, kufizimet aktuale në kornizën ligjore dhe institucionale e vënë në rrezik procesin e sigurimit të

përgjegjësive për veprat serioze penale të zbuluara në përgjimet", tha Prins.

Ndërsa Xhefri Goldstajn, shefi i misionit të OSBE-së në Shkup, tha se bazuar në analizat e Raportit të parë të përkohshëm për aktivitetet dhe rastet që janë nën kompetencë të PSP-së, rekomandojmë që të ndryshohet legjislacioni në pajtueshmëri me Strategjinë kombëtare për reformat gjyqësore 2017-2022, pa marrë parasysh se çfarë vendimi do të marrë ligjvënësi në lidhje me vazhdimësinë dhe vendosjen në rastin Titanik 2.

"Gjithashtu, rekomandojmë që të gjitha rastet të përfundohen me qëllim që të sigurohet përgjegjësi e plotë për veprat penale të zbuluara në përgjimet. Shpresojmë se gjykimi i drejtë dhe efikas i rasteve të PSP-së do të shërbejë si një mekanizëm për ta rindërtuar besimin në sistemin e drejtësisë penale në vend. Edhe pse PSP ka qenë e zellshme në sigurimin e transparencës për publikun, ka disa fusha në të cilat mund të bëhen më shumë përpjekje për ta ofruar informacionin përkatës me kohë", tha Goldstajn. Ndërkohë, prokurorja Katica Janeva sërish dërgoi kritika të ashpra ndaj gjykatave duke akuzuar se në mënyrë selektive, disa gjykata caktojnë seancat gjyqësore duke i anashkuar të gjitha lëndët e ngritura nga PSP-ja.

"Si mundet të caktohen 55 seanca gjyqësore nga Gjykata Themelore Shkupi 1 për të akuzuarit e rastit 27 prilli, ku u sulmua Parlamenti i Maqedonisë, ndërsa për lëndën vëllimore siç është 'Titanik', deri më tani të caktohet vetëm një seancë", u shpreh Janeva. "Në vend që Gjykata e Apelit të miratojë vendimin për paraburgimin e dy të dyshuarve për shkatërrimin e aparatit për përgjim - Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski, prolongoi afatin e miratimit të vendit dhe të njëjtëve ju dha hapësirë që të ikën nga Maqedonia. Apejojë edhe deri te Gjykata e Apelit të përshpejtojë procedurat e PSP-së që për momentin janë në shkallë të dytë", tha Janeva. Duke folur për aktivitetet e ardhme të PSP-së, Janeva potencoi se deri më tani janë dëgjuar 85 për qind të përgjimeve dhe se së shpejti do të ketë dhe aktakuza të reja për personat të cilët kanë keqpërdorur funksionin shtetërorë apo kanë kryer veprat penale.

## KRONIKË

### Dërgohet në burg 55 vjeçari, kërkohet për plaçkitje

Pjesëtarë të Policisë së Gostivarit të martën rreth orës 16 e 10 minuta në rrugën "Goce Delçev" në qytetin e Gostivarit kanë arrestuar 55 vjeçarin S.M nga fshati Koritë i dënuar me tre vite burg për veprë penale "plaçkitje". Pas arrestimit dhe mbajtjes së shkurtër, të realizuar me urdhër të gjykatës, personi në fjalë është sjellur në burgun e Tetovës për të vuajtur dënimin.

### Blen cigare me 100 euro fals

52 vjeçarja J.L nga fshati Jançishtë, e punësuar në një kioskë në rrugën "18 nëntori" në Gostivar, të martën ka denoncuar se rreth orës 15 e 30 minuta, në lokal ka ardhur një person i panjohur i cili ka blerë 20 pako me cigare dhe ka paguar me bankënotë prej 100 euro dhe ajo i ka kthyer 3300 denarë. Pasi është larguar personi, ajo ka konstatuar se bankënota ka qenë e falsifikuar. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

### Lëndohet rëndë traktoristi

Një traktorist nga fshati Krushopek është lënduar pasi e ka humbur kontrollin ndaj traktorit dhe është përmbysur. Pesëdhjetë e një vjeçari F.M. me lëndime të rënda trupore është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm të qytetit "8 Shtatori" ku i është dhënë ndihma mjekësore. Aksidenti ka ndodhur dje në orën 11:40 në rrugën lokale të fshatit Nerez- fshati Krushopek.

### Vidhet vetura Pollo në Tetovë

36 vjeçari me iniciale M.Z nga Tetova, të martën rreth orës 12 ka denoncuar se një natë më herët i është vjedhur vetura Volsfagen Pollo, me targa të Tetovës, e cila ka qenë e parkuar në rrugën e Ilindenit. Vetura ka qenë e parkuar dhe nuk ka qenë e mbyllur, ndërsa brenda ka pasur dokumente personale. Janë marrë masa për gjetjen e veturës.

### Një britanik me automobil ka goditur një çiklist

Një britanik mbrëmë duke drejtuar automobilin "mitsubishi" ka goditur një çiklist në rrugën "Hristo Tatarçev" në Shkup pas së cilës çiklisti i lënduar është dërguar në kompleksin e klinikave "Nëna Terezë" dhe është mbajtur për shërim të mëtutjeshëm. Ministria e Punëve të Brendshme sot kumtoi se aksidenti ka ndodhur mbrëmë në orën 20:15 kur 51 vjeçari Xh.P. nga Britania e Madhe me vendbanim në Bullgari ka goditur në 39 vjeçarin M.P. Çiklisti me automjetin e Ndhmës së Shpejtë mjekësore është dërguar në Qendrën klinike ku i janë konstatuar lëndime të rënda trupore. Është kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes.

### Gjendet minahedhës dore në lumin Vardar

Në shtratin e Lumit Vardar, në rrugën Jegunoc-Radushë, në vendin e quajtur Livadhet e Sinaanit, të martën rreth orës 18 e 30 minuta, një peshkatar ka gjetur një minahedhës dore RPG, e cila ka qenë e mbyllur me dega dhe ka qenë mjaft e ndryshkur. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe minahedhësi është dërguar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim. (U.H)

## "FORTESA-TARGET" DO TË DËSHMOJË SE 20.000 QYTETARË U PËRGJUAN

Prokuroria Speciale Publike (PSP) ka shumë prova se personat të cilët akuzohen në rastin "Fortesa-Target" kanë përgjuar dhe këtë do ta dëshmojmë para gjyqit, ka thënë dje Prokurorja Speciale, Katica Janeva, e cila shpreson se të premtën do të fillojë procesi gjyqësor për këtë lëndë. "Fortesa-Target" është lëndë se persona zyrtarë të DSK-së kanë shkatërruar pajisjen që të mos mund të vërtetohet se me ato pajisje është përgjuar. Kemi ekspertizë forenzike ku vërtetohet se kush, si dhe në ç' mënyrë është përgjuar. Kemi dëshmi në lëndën që ende nuk ka filluar në gjyq, ndërsa do të duhet të fillojë dhe shpresoj se të gjithë do të jemi të pranishëm të vërtetojmë se kush ka përgjuar. PSP ka shumë dëshmi se kush ka përgjuar dhe nuk mund këtë lëndë t'ia jep Prokurorisë themelore publike", ka thënë Janeva.



Asnjë nga shkollat me mësim në shqip, ose të paktën ku mësohet edhe gjuha shqipe, nuk ka arritur të renditet në listën e tre vendeve të para, ku suksesi është mbi notën 4 ose rreth 4. Alarmante është situata në shkollat e Tetovës, pasi mu aty gjendet edhe shkolla me sukses më të dobët në Maqedoni

Koha

Aida XHONI

Shkup, 29 gusht - Nga rezultatet e notave përfundimtare të shkollave të mesme të Maqedonisë, mund të konstatohet se situata është alarmante! Vetëm një nga qindra shkollat e mesme sa gravitojnë në nivel republikan, ka arritur vitin e kaluar të ketë sukses mbi 4, të tjerët mezi kanë arritur të sigurojnë notën trash! Për dallim nga nxënësit e shkollave të mesme, raportet zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës thonë se nxënësit në fillore mësojnë më shumë, ndërsa më rëndë arrijnë tek pesëshet gjatë arsimimit të mesëm, njofton KOHA.

Vetëm një shkollë ka mesatare me notë të mesme mbi 4, ndërsa shumë të tjera mezi kanë marrë notën 3. Nga qindra shkolla të mesme me mesatare më të ulët se 3 janë rreth 40 shkolla. Për dallim nga shkollat e mesme, lista me filoristët e Qytetit të Shkupit tregon se përqindjet e shkollave janë më të larta. Asnjë nga shkollat me më-

ALARMANTE!

# SHKOLLAT SHQIPE MEZI ARRIJNË TRESHIN!



sim shqip, ose të paktën ku mësohet edhe në shqip, nuk ka arritur të renditet në listë me tre vendet e para, ku suksesi është mbi 4 ose rreth 4.

Nota më të mira në nivel republikan kanë nxënësit e gjimnazit të Shkupit "Orce Nikollov". Vjet, në fund të vitit shkollor, nota mesatare në këtë shkollë ka qenë 4.18. Nxënësit e gjimnazit "Rade Jovçev-

ski - Korçagin" vjet kanë arritur notë 3.98, më pas renditet gjimnazi i Ohrit "Shën Klimenti i Ohrit" me 3.92 dhe gjimnazi i Kumanovës "Goce Dellçev", me notë mesatare 3.90.

Alarmante është situata në shkollat e Tetovës, pasi mu aty gjendet edhe shkolla me sukses më të dobët në Maqedoni. Nxënësit e shkollës së mesme të Tetovës

"Gjoce Stojçevski", me gjasë nuk kapin libër në dorë, pasi kjo është shkolla më e dobët në Maqedoni me notë mesatare vetëm 2.09. Komuna e Tetovës ka rezultate më të dobëta, aty nota mesatare në nivel komunal arrin vetëm 2.66. Nga shtatë shkolla të mesme në Tetovë, pesë janë me sukses të mjaftueshëm - notë 2, ndërsa rezultate më të mira ka shkolla e muzikës "Todor

Skallovski - Tetoec", me 3.66, më pas gjimnazi "Kiril Pejçinoviç", me mesatare 3.28.

Hiç më mirë nuk qëndrojnë Shkollat e Shkupit që kanë kryesisht nxënës shqiptarë. Gjimnazi "Zef Lush Marku", që njihet si ndër shkollat e mesme më të vjetra dhe më të suksesshme në historinë e saj, këtë vit mezi ka arritur të sigurojë notën 3, respektivisht vitin e kaluar shkollor ka arritur mesatare vetëm 2.88 që është afërsisht me suksesin mesatare të shkollës së re të mesme në Saraj, e cila ka përfunduar vitin e kaluar me sukses mesatar prej 2.86. Shkolla e mesme e qytetit të Shkupit "Cvetan Dimov" ka arritur notën mesatare 2.59, shkolla e mesme profesionale e mjekësisë "Dr Pançe Karagjov" 3.54, shkolla e mesme ekonomike "Arseni Jovkov" e përfundoi vitin e kaluar me notë 2.78, ndërsa shkolla e kimisë "Marija Kiri" me 2.96.

Në nivel komunal ku ka më shumë se pesë shkolla të mesme, sukses më të mirë kanë shkollat e Manastirit me notë 3.36, shkollat e Shkupit me sukses 3.23, Kumanovës me 3.19, më pas Prilepi me 3.07. Në Qytetin e Shkupit, nga 24 shkolla të mesme, madje 13 kanë notë të mjaftueshme nën trash!

Katër shkollat e mesme në Gostivar kanë arritur mesatare prej 3.14, shkolla e vetme e Dibrës ka arritur sukses 2.88, shkolla e mesme "Rilindja" në Zhitoshë të Komunës së Dollnenit ka mesatare 2.31, pesë shkollat e Kumanovës kanë arritur sukses 3.19. Shkolla "Ismet Jashari" e Likovës vitin e kaluar e përfundoi me sukses mesatar 2.72. Dy shkollat e mesme të Kërçovës - "Mirko Milevski" ka arritur mesatare 3.24, ndërsa "Drita" me notë 2.91.

AKOMA INSISTOHET QË KAZINOTË TË JENË TRE KILOMETRA LARG QYTETIT

## Kazinoja në Reçicë nuk do hapet

Këtë e kanë bërë të ditur nga Lëvizja Anti-Bixhoz, të cilët kanë mirëpritur këtë vendim të institucioneve qendrore që të mos lejohet hapja e kazinosë afër kësaj lagje, afër Universiteteve dhe shkollave të mesme

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 29 gusht - Para dy jave, Drejtoria për të Hyra Publike ka marrë vendim që të mos hapet kazinoja Reçicë të Vogël. Këtë e kanë bërë të ditur nga Lëvizja Anti-Bixhoz, të cilët kanë mirëpritur këtë vendim të institucioneve qendrore që të mos lejohet hapja e kazinosë afër kësaj lagje, afër Universiteteve dhe Shkollave të Mesme. Jushi Emërllahu nga Lëvizja Anti-Bixhoz, ka thënë se ditën e hënë, është mbajtur lexim i parë i propozim-ligjit për ndryshimin e Ligjit për organizimin e lojërave të fatit. "Kërkesa jonë në

këtë debat ka qenë që kazinotë të jenë larg shtëpisë së fundit të qytetit tre kilometra. Për këtë ndërhyrje në ligj, para dy muajve kemi dorëzuar edhe amendament, por oferta e koalicionit dhe partisë në pushtet - BDI, e propozuar nga Ejup Alimi dhe Rexhail Ismaili, është 500 metra vijë ajrore prej parcelës së fundit, apo 500 metra larg nga vendi ku parashihet të jetë objekti i lojërave të fatit", deklaroi Emërllahu. Sipas tij, brenda javës do të ketë edhe një debat tjetër, në lexim të dytë dhe do të insistohet që largësia e këtyre objekteve nga institucionet të jetë tre kilometra.

"Brenda javës do të ketë debat tjetër të hapur, ku do të saktësohet se sa do të jetë largësia prej institucioneve shtetërore duke përfshirë edhe objektet fetare. Jemi të ftuar në këtë debat dhe do të kërkojmë të respektohet marrëveshja prej tre kilometrave, sepse kjo është paraparë në amendamentet e para. Mirëpo, edhe pse me 500 metra vijë ajrore largohen të gjitha objektet e lojërave të fatit nga qyteti, ne si lëvizje Anti Bizhos, do të insistojmë të jetë sa më e gjatë", thotë Emërllahu. Ai sqaroi se me miratimin e këtij Ligji, afati për dislokimin e të gjitha objek-

teve të fatit është 31 dhjetori i këtij viti dhe më 1 janar, asnjë objekt i këtyre nuk duhet të jetë afër institucioneve shtetërore dhe fetare. Ne si Lëvizje do të kërkojmë që të implementohet urgjentisht ky Ligj në praktikë.

"Në të kundërtën, ne do të vazhdojmë me protestat tona para institucioneve shtetërore përgjegjëse për këtë ligj. Me këtë propozim-ligj të ri, komunave u jepet e drejta që të jenë përgjegjëse për largësinë e hapjes së kazinove dhe për dhënien e lejes definitive të lojërave të fatit, apo dokumentit final, me një fjalë komuna do të ketë të drejtë të pengojë hapjen e një veprimtarie të këtyre dhe ka të drejtë vendimmarrje", theksoi Jushi Emërllahu.

Përndryshe, kohë më parë, edhe Komuna e Tetovës përmes Këshillit komunal kishin kërkuar përfshirjen e saj në vendimmarrje për hapjen e veprimtarive që kanë të bëjnë me lojërat e fatit. "Këshilli i Komunës së Tetovës në njërën nga mbledhjet e saj ka marrë pesë vendime që i janë dërguar institucioneve përkatëse. Nga ky vendim gjeneralisht, kërkohet involvimi i Komunës në sjelljen dhe miratimin e Ligjit të ri, i cili rregullon veprimtarinë e lojërave të fatit si dhe



distancimi i këtyre veprimtarive në pjesët periferike të qytetit", njoftojnë nga Komuna e Tetovës.



MINISTRI BEKTESHI NË BIT PAZAR

# LICENCA QË RREGULLOJNË STATUSIN E PAZARXHINJËVE

Zgjidhja e statusit të personave fizik përmes regjistrimit të veprimtarisë së tyre tek Oda e tregtarëve të Maqedonisë, do t'ju mundësoj atyre të jenë pjesë e komunitetit të biznesit në Maqedoni, tha ministri Bekteshi

Koha Remzije BILALI

Shkup, 29 gusht - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, realizoi takim pune në zyrat e Odës së tregtarëve të Maqedonisë, ku para kryetarit të kësaj ode, Ekrem Dolek, përfaqësuesve të Komunës së Çairit dhe të Ndërmarrjes 'Skopski Pazar', prezantoi aktet e nënshkruara nënligjore të Ligjit për tregtarët në tregjet e gjelbërta, me të cilat rregullohen kushtet dhe mënyrat e organizimit të tregjeve të gjelbërta, nga të cilat tregtarët do të kenë beneficione të shumta. Pas takimeve, ministri Bekteshi vizitoi tregtarët e Bit Pazarit, të cilët e përshëndetën rregullimin e statusit të tyre.

Bekteshi para pazaxhinjëve tha se pas shumë viteve të kërkesës së tyre, u firmosën aktet nënligjore nga Ligji për tregtarët në tregjet e gjelbërta, të cilat përcaktojnë subjektet që mund të shesin në tregjet e gjelbërta, mënyrën e regjistrimit të tregtarëve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

"Me këto akte nënligjore fillon



regjistrimi dhe licencimi i tregtarëve në tregjet e gjelbërta, nëpërmjet Odës së tregtarëve të Maqedonisë, të cilën e kryeson z.Ekrem Dolek, e cila do të ofrojë shërbime për tregtarët në tregjet e gjelbërta, ndërsa ne si ministri, pazaret ua kthejmë pazaxhinjëve, sepse me këtë ligj pazaxhinjëve ju mundësojmë evidentim dhe zyrtarizim të punës së tyre, lehtësimin e procedurës së regjistrimit të veprimtarisë, obligimet për pagesën e tatimit dhe kontributeve, dhe me këto hapa neve mundësojmë përparim në zvogëlimin e ekonomisë gri, tregëtisë jologjore si dhe konkurrencës jologjale", tha ministri Bekteshi. Ai shtoi se me këtë ligj vendoset rend rreth sigurisë së ushqimit, kualitetit të prodhimeve bujqësore dhe shëndetin e bimëve, ndërsa fitues janë edhe pa-

zaxhinjtë, edhe shteti edhe qytetarët.

Zgjidhja e statusit të personave fizik përmes regjistrimit të veprimtarisë së tyre tek Oda e tregtarëve të Maqedonisë, do t'ju mundësoj atyre të jenë pjesë e komunitetit të biznesit në Maqedoni, tha ministri Bekteshi. Kryetari i Odës së tregtarëve të Maqedonisë, Ekrem Dolek, shprehu kënaqësinë për zgjidhjen nga ana e Ministrisë së Ekonomisë të këtij problemi për tregtarët në pazare.

"Me nënshkrimin e akteve nënligjore përfundon procesi i zbatimit të Ligjit për tregjet e gjelbra të miratuar në fillim të këtij viti dhe ky është një hap i madh në këtë sferë, i cili nuk ishte i rregulluar që nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë. Pazaxhinjtë kishin një status të pazgjidhur, të gjithë pu-

nonin kokë më vehte, dhe ishin burim i konkurrencës jologjale dhe ekonomisë gri. Brenda një kohe shumë të shkurtër të gjitha këto fenomene negative ekonomike do të bëhet histori, dhe angazhimi ynë në bashkëpunim me tregtarët e tregjeve do të vazhdojë përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, furnizimin me produkte me cilësi më të mirë, dhe nga organizatorët e tregjeve do të kërkojmë të përmirësojmë kushtet e punës për tregtarët. Kjo qeveri ka treguar vëmendje për problemet tona si dhe vullnet politik për të gjetur zgjidhje për to", tha Dolek. Në Maqedoni, tregje të gjelbra ka në mbi 50 komuna, me mbi 15 mijë tregtarë, ndërsa vetëm në Shkup ka 13 tregje të gjelbërta, mes të cilave tregu i Bit Pazarit është më i madhi në Maqedoni.

## Një miliardë euro akumulohen në dy shoqatat e pensioneve

Shkup, 29 gusht - Rreth 500 mijë anëtarë kanë dy shoqatat pensionale në shtyllën e dytë nga sigurimi i obliguar kapital financiar pensional. Mjetet e përgjithshme të cilat në këto dy shoqata pensionale janë akumuluar nga formimi i tyre e deri më tani arrijnë rreth një miliardë euro.

Siç informoi në seancën e djeshme të Komisionit parlamentar për punë dhe politikë sociale anëtari i Këshillit të MAPAS, Agjencia e cila obligohet për supervizion të këtyre shoqatave pensionale, Darko Sazdov, kryhen kontrole të rregullta në punën e tyre. Kontrollet, theksoi ai, në mënyrë të jashtëzakonshme zhvillohen në bazë ditore, ndërsa në terren në nivel vjetor.

MAPAS, potencoi Sazdov, duke e prezantuar Raportin për punën e vitit të kaluar, përveç supervizionit të punës së shoqatave të pensioneve dhe të ngritjes së ndërgjegjësimit të opinionit për, siç tha, synimeve dhe parimeve të sigurimit të obligueshëm kapital financiar pensional. Shtylla e parë është fondi i obligueshëm shtetëror pensional - Fondi i SPIM, i cili funksionon në parimin e solidaritetit të gjeneratës. Shtyllën e dytë e përbëjnë fondet e obliguara private pensionale, ndërsa të siguruarit përzgjedhin njërin prej tyre. Mjetet e investuara në shtyllën e dytë investohen sipas rregullave të konfirmuara dhe sigurojnë shkallë më të lartë të mbrojtjes së personave të siguar dhe të mjeteve të tyre. Në shtyllën e parë nga gjithsej 18 për qind kontribute për sigurimin pensional nga bruto-pagat paguhen 12 për qind, ndërsa në të dytin 6 për qind.

SHOQATA "NË BIÇIKLETË" ME KËRKESË DREJTUAR KOMUNAVE

## Transport pa automobila!

Shkup, 29 gusht - Shoqata joformale "Në Biçikletë" dje në masën kritike të 76-të, së bashku me çiklistët në qytet, kanë kërkuar nga komunat përpjekje më të mëdha në përkrahjen e transportit të shëndetshëm në qytet.

Ata nga Qyteti i Shkupit dhe tetë komuna kërkuar ngritje të vetëdijes për transport që nuk përfshin automobila, si lloj i dëmshëm dhe joefektiv i transportit dhe përpjekje më të mëdha të kahëzuara drejt ndërrimit të shprehive momentale të transportit.

Si hap i parë në atë është shënimi i Ditës Botërore pa automobila më 22 shtator.

Shumë qytete përrreth Evropës do t'i mbyllin rrugët e tyre për qarkullim të automobilave për një ditë në shtator, si pjesë e fushatës Një ditë pa automobila (Car - Free Day) në suaza të European Mobility Week të sivjetëm. Duke filluar nga 22 shtatori i vitit 2000, kur 760 qytete përrreth Evropës e përkrahën organizimin e Ditës pa automobila, çdo vit marrin pjesë edhe qytete të reja qartë duke treguar

se fillojnë plan i cili do t'i ndërrojë qytetet e tyre në lidhje me politikat transportuese. Se kanë plan në të cilat përparësi do të ketë jeta cilësore e njerëzve. Dita pa automobila është ditë kur festohet transporti i shëndetshëm në një qytet. "Në Biçikletë" propozon që çdo komunë në Shkup, më 22 Shtator (e shtunë), të mbyllë një rrugë për qarkullim me automobila e cila është në kompetencë të komunës, por edhe të përgatisë program dhe të organizojë aktivitete për qytetarët (me artistë lokal, muzikantë,



shoqata etj), në atë rrugë gjatë ditës, me çka do t'i motivojë të vijin dhe të qëndrojnë në atë rrugë, që ta përjetojnë në mënyrë më ndryshe. Gjithsesi vetë qyte-

tarët duhet paraprkishtë të informohen mirë dhe të njoftohen me qëllimin e ditës, me aktivitetet të cilat do të ndërmerren edhe për mbylljen e rrugëve. (R.B)



Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 nga Vendimi për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit nr. 07-7450/1 të datës 30.10.2014 Fleta Zyrtare e Qytetit të Shkupit nr. 12, Vendimit të këshillit të shkollës nr. 02-463/1 dhe pëlqimit të marrë nga Kryetari i Qytetit të Shkupit nr. 08-7242/2 të datës 27.08.2018, Komisioni për ankad publik pranë SHMQSH Gjinnazi Rade Jovčevski – Korçagin Shkup publikon:

#### SHPALLJE

Për dhënie me qira të pronës së patundshme dhe termin në sallën e shkollës me ankad publik  
**Qiradhënës:** SHMQSH Gjinnazi Rade Jovčevski – Korçagin Shkup me seli në “III Makedonska Udarina Brigada” nr. 9 – Shkup, tel. 02/3115-116, faks: 02/3115-116 lokali 108.

#### 1. Lënda e qirasë përbëhet prej:

- 1. Pjesë të oborrit të shkollës dedikuar për kryerje të veprimtarisë hotelerike – bife me sipërfaqe prej 17,5 m<sup>2</sup>.**  
1.1. Çmimi fillestar i ankandit publik për dhënie të hapësirës është 10 euro për 1m<sup>2</sup> në kundërvlerë denarë. Hapi minimal për rritje të vlerës për 1m<sup>2</sup> të pronës së patundshme është 10% e çmimit fillestar për metër katror.
- 2. Hapësirë bodrumi me sipërfaqe prej 50m<sup>2</sup> me qëllim për klub për gjuajtje.**  
2.1. Çmimi fillestar i ankandit publik për dhënie të hapësirës është 1 euro për 1m<sup>2</sup> në kundërvlerë denarë. Hapi minimal për rritje të vlerës për 1m<sup>2</sup> të pronës së patundshme është 10% e çmimit fillestar për metër katror.
- 3. Dhënie të terminëve në sallën e vogël -** Dhënie të terminëve në sallë të vogël, termini vërtetohet në 60 minuta, një orë. Çmimi fillestar i ankandit publik vërtetohet në vlerë prej 350,00 denarë për një termin, hapi minimal për ngritjen e vlerës për një termin është 10% nga çmimi fillestar për ankad

#### 4. Afati dhe kushtet të cilat duhet ti plotësojnë pjesëmarrësit:

- 4.1. Shpallja zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit.
- 4.2 Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë subjektet e interesuara juridike të cilët deri tek komisioni për ankad publik do të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:
  - Dokument për veprimtari të regjistruar, jo më të vjetër se 6 muaj;
  - Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent;
  - raport për bilancin e gjendjes dhe të dhënat për bilancin e suksesit, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent;
  - Certifikatë për tatime dhe kontribute të paguara, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent;
  - fletëpagesë për depozitë të paguar.
5. Dokumentacioni dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë “mos hap” dhe me shenjë “për shpallje për dhënie me qira të pronës së patundshme” dhe numrin e shpalljes, dhe dorëzohet përmes postës në adresën “III Makedonska Udarina Brigada” nr. 9 – Shkup, ose në arkivin e shkollës, më së voni deri në ora 13.00 në ditën e fundit të shpalljes. Ofertuesi i cili nuk do të dorëzojë dokumentet e nevojshme nuk do të ketë të drejtë të merr pjesë në ankandin publik. Dokumentet e dorëzuara në shpallje nuk kthehen.

#### 6. Koha e fillimit të ankandit publik:

Për secilën lëndë të veçantë realizohet ankad i veçantë:  
 Ankandi publik në lidhje me lëndën e parë për qira 1. Pjesë të oborrit të shkollës dedikuar për kryerje të veprimtarisë hotelerike – bife me sipërfaqe prej 17,5 m<sup>2</sup> do të fillojë më datë 14.09.2018, në ora 10 në lokalet e shkollës me kohëzgjatje prej 15 min. Ankandi publik në lidhje me lëndën e dytë për qira 2. Hapësirë bodrumi me sipërfaqe prej 50m<sup>2</sup> me qëllim për klub për gjuajtje, do të fillojë më datë 14.09.2018, në ora 10<sup>15</sup> në lokalet e shkollës me kohëzgjatje prej 15 min. Ankandi publik në lidhje me lëndën e tretë për qira 3. Dhënia e terminëve të sallës së vogël, do të fillojë më datë 14.09.2018, në ora 10<sup>30</sup> në lokalet e shkollës me kohëzgjatje prej 15 min.

#### 7. Depozita

7.1 Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik është 2.100,00 denarë e cila duhet të paguhet deri në ditën e përfundimit të shpalljes në xhiro llogarinë e shkollës 785010364678711, shifra e të ardhurave 723019, programi N2. Pajesa pas kalimit të afatit do të llogaritet si e vonuar dhe personat të cilët nuk ka në realizuar pagesën në kohë në pajtim me afatin e caktuar nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik. Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik nuk kthehet.

#### 8. Mënyra e realizimit të ankandit publik dhe zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm:

8.1. Ankandi publik mund të fillojë me së paku me një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e theksuara në shpallje dhe ofron çmimin fillestar. Pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ofron çmimin më të lartë do të marrë statusin ofertuesi më i volitshëm.

#### 9. Kohëzgjatja e qirasë:

- 9.1. Hapësira jepet me qira për periudhë prej dy vjet për hapësirën shkollore dedikuar për bife të shkollës, ndërsa një vit për hapësirën dedikuar për klub për gjuajtje dhe terminin në sallë të vogël. Marrëveshja me ofertuesin më të volitshëm do të nënshkruhet në afat prej 5 (pesë) ditëve pas marrjes së pëlqimit nga Kryetari i Qytetit të Shkupit. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk lidhë marrëveshje atëherë do të lidhet marrëveshje me ofertuesin e radhës.
- 9.2. Qiramarrësi është i obliguar që të paguajë depozitë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denarë për mbulim të dëmit të mundshëm gjatë shfrytëzimit të hapësirës në afat prej 3 ditëve, nga dita e lidhjes së marrëveshjes dhe e njëjta do të kthehet në tërësi në afat prej 15 ditëve pas skadimit të marrëveshjes.

Komisioni për dhënie me qira të pronës së patundshme të SHMQSH “Rade Jovčevski – Korçagin” – Shkup

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 164-b i Ligjit për mbrojtje shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/12,145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) , Pëlqimin për punësim nga Ministria e financave nr. 18-5658/2, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-338/1 të datës 24.08.2018 nga U.D Drejtoria medicinal Këshilltar shkencor d-r spec. Niko Beqarkovski i IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup publikon

#### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror

1. IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup ka nevojë për punësim të:

1.1 **dy (2) personave në vendin e punës – doktor të medicinës specialistë të mjekësisë interne.**

2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- Të jetë shtetas i RM,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- Të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar të VII/1 – Fakulteti i mjekësisë
- provim të dhënë profesional
- provim të dhënë të specializimit
- licencë për punë
- me përvojë pune
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, gjermane dhe frënge) të nivelit B2 sipas Komizës referente të përbashkët për mësim, ligjërime dhe vlerësim të gjuhëve (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.

- Njohja e gjuhës së huaj, përveç certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohej edhe me vërtetim për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të ranguara në Shanghai Ranking - ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidati posedon diplomë të nostrifikuar.

4. Orari i punës prej 40 orë në javë dhe neto pagesë fillestare prej:

- Për kandidatin nga pika 1.1 është 38,654,00 denarë

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët obligohen të parashtrijnë dokumentet në vijim

- fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- biografi të shkurtë (CV)
- njohja e gjuhës së huaj dëshmohej me parashtrimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë të njohur tjetër ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizate tjetër ndërkombëtare të nivelit B2 të Komizës së përbashkët referente për mësim, ligjërime dhe vlerësim të njohjes së gjuhëve (CEFR).
- Kandidatët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e medicinës në një prej 100 fakultetet më të mirë të ranguara të Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk kanë nevojë të përmbushin kushtet e posaçme nga pika 3 e kësaj shpallje, as edhe për punësimin e tyre realizohet procedurë për selektim të kandidatit.
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për provim të dhënë specialistik
- licencë për punë, origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët të cilët kanë përfunduar arsim përkatës jashtë vendit duhet të posedojnë:

- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës
  - Dokument për ekuivalencë të notave, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- Orari i punës organizohet me ndërrime ose kujdestari dhe zgjatë 40 orë në javë, pagesa do të paguhet në pajtim me Marrëveshjen individuale kolektive.
6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e Komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.
8. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur do të realizohet provim në pajtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.
9. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen deri në IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup, ndërsa me shenjë Për shpalljen publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup

Në bazë të nenit 126 dhe 130 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08) dhe Vendimit të Këshillit të shkollës, Shkolla fillore komunale “Partenije Zografski” publikon:

## SHPALLJE

**Për dhënie me qira të hapësirave afariste të objektit të shkollës për kohët e caktuar në SHFK Partenije Zografski – Shkup, Komuna e Kisella Vodës**

1. **Qiradhënësi:** SHFK “Partenije Zografski” Kisella Vodë – Shkup, rr. “Dositej Obradoviq” nr. 18, tel. 2770-719, faks 2700-150.

#### 2. Ofertuesi:

Të drejtë për të shtruar kërkesë për marrje me qira të objektit të theksuar të shkollës ka secili subjekt i interesuar fizik ose juridik i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën për qira.

#### 3. Lënda e qirasë:

- salla sportive e shkollës
- klasa
- hapësira të bodrumit
- shitorja e shkollës
- hangarët

Numri rendor	Hapësira – përshkrimi i hapësirës	Sipërfaqja e objektit për m <sup>2</sup>	Kati/Lokacioni i objektit	Termini i shfrytëzimit	Çmimi fillestar
1	Salla sportive e shkollës	460		Orë	800 MKD
2	Klasa	56	Kati 1	Orë	500,00 MKD
3	Hapësirat e bodrumit	70	Bodrum	Muaj	9.000,00 MKD
4	Shitorja e shkollës	9	Përdhese	Muaj	9.000,00 MKD
5	Hangarët	90	Oborri i shkollës	Muaj	13.500,00 MKD

#### 4. Objekti jepet me qira për periudhë për një vit.

#### 5. Shtojcat e nevojshme së bashku me ofertën:

- Emri, mbiemri dhe adresa për personin fizik;
- Emri dhe selia e subjektit juridik, xhiro llogaria, banka deponent, numri tatimor personal;
- Dëshmi për identitet – fotokopje të letërnjoftimit ose gjendja aktuale nga regjistri Qendror për subjektet juridike jo më të vjetër se 6 muaj;
- Vërtetim nga gjykata kompetente ndaj subjektit juridik se nuk është hapur procedurë për falimentim ose likuidim, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Saktësisht të theksohet se për cilën hapësirë konkurrohet, dhe cila shumë ofrohet;
- Për cilën veprimtari ose qëllim kërkohet hapësira.

Ofertat me shkrim dorëzohen në adresën: SHFK “Partenije Zografski” – Shkup, rruga Dositej Obradoviq numër 18, me dërgesë rekomanduese ose në Arkivin e shkollës, me shenjë: PËR SHPALLJE për dhënie me qira të objektit të shkollës. Në skajin e epërm të majtë të zarfit të vërtetuar të shënohet MOS HAP dhe numri rendor nën të cilin është publikuar objekti i shkollës në shpallje.

#### 6. Zgjedhja e ofertës më të volitshme:

Oferta më e volitshme zgjidhet në bazë të:

- Çmimi më i lartë i ofruar;
- Veprimtaria e cila realizohet,

në pajtim me Rregulloren për dhënie me qira të hapësirës afariste.

Ofertat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh nga ana e Komisionit. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

**SHFK “Partenije Zografski” – Kisella Vodë, Shkup**



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
 AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpunëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunëve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimin të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

#### SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 163/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - Drejtoria e Punëve Hidrometeorologjike “për vendet e punës në vijim:

1. UPR 01 01 B02 000 Udhëheqës i njësies për parashikim dhe paralajmërim

1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Gjeofizikë
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tete) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e preme
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 34.474,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



Është konstatuar se dobitë nga Fondi solidar në periudhën e deritanishme janë treguar si ndihmë e madhe financiare për shpenzime post-mortore të familjeve në ato momente të dhimbshme për më të afërmit, ndërsa gjithashtu është shumë me rëndësi edhe pagesa prej 30 denarëve e anëtarësisë që paraqet lëvizësin kryesor të organizimit pensional të gjeneratës së tretë

Këshilli mbikëqyrës i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë më datë 27.07.2018, ka mbajtur mbledhjen e 10 të, me të cilën ka udhëhequr kryetari i Këshillit mbikëqyrës, Mitre Stojanovski. Në mbledhje krahas anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, kanë marrë pjesë edhe Saltir Karovski, nënkryetar i Këshillit ekzekutiv të LSHPM, Stanka Trajkova, sekretari i Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe Petar Andreevski, kontabilist i LSHPM.

Në mbledhje u shqyrtua Propozim-raporti financiar për të hyrat e realizuara dhe të dalat e bëra për periudhën janar-qershor 2018 dhe Informacioni për Fondin solidar për anëtarësim dhe ndihmën post-mortore për vitin 2017.

Fjalimin hyrës për Propozim-raportin financiar për të hyrat dhe

## NË MBLEDHJEN E 10-TË TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË LSHPM REZULTATE POZITIVE FINANCIARE



të dalat e realizuara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, e mbajti kryetari i Këshillit mbikëqyrës. Më pastaj kishte diskutim, në të cilin morën pjesë: anëtarët e Këshillit mbikëqyrës Nijazi Xheli dhe Mirko Danaillov, Saltir Karovski, nënkryetar i KE, Stanka Trajkova, sekretare e KE dhe Petar Andreevski, kontabilist përgjegjës për Lidhjen. Diskutimi ishte konstruktiv, ndërsa mendimet e pjesëtarëve në diskutim janë përfshirë në vazhdim të tekstit. Konstatimi i përgjithshëm për raportin financiar është si në vijim:

Gjithsej të hyrat e realizuara në periudhën janar-qershor 2018 janë 5.935,7 denarë, ku është vërejtur një rritje prej 9,3% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2017, prej të cilave: të ardhurat aktuale janë 4.735,7 denarë dhe mjetet e transferuara prej vitit 2017 që janë 1.200 denarë. Të ardhurat e përgjithshme aktuale shënojnë rritje prej 5,1%. Tek ata shkalla dominuese janë të ardhurat nga anë-

tarësimi që është 3.987,5 denarë në pjesëmarrje strukturore prej 84,2%.

Të dalat e përgjithshme të realizuara në periudhën janar-qershor 2018 janë 4.533 denarë dhe shënojnë rritje prej 10,9% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e konsiderueshme është si rezultat i furnizimit me automjet të ri që ka kushtuar 907,8 mijë denarë, ndërsa shkallët tjera grupore kanë shënuar rënie të lehtë. Në gjysmëvjetorin e dytë priten aktivitete të shumta, por vlerësimi është se shpenzimet e planifikuara me planin financiar do të realizohen në tërësi. Nga analiza e detajuar e realizuar e pikave dhe nën-pikave të të dalave fitohet përshtypja në vijim:

Pika të dalat funksionale nga pjesëmarrja strukturore prej 46,7%, shënon ulje në krahasim me vitin e kaluar dhe është 11%, por nën-pikat: shpenzimet për KE janë rritur për 72% si rezultat i mbajtjes së më shumë takimeve

në krahasim me vitin e kaluar, shpenzimet e Komisionit për jetën kulturore argëtuese kanë shënuar rritje prej 135%, si rezultat i aktiviteteve të rritura për revytë rajonale dhe republikane të këngëve, muzikës dhe lojërave, shpenzimeve për botimin e gazetës "Penzioner Plus" që shënojnë rritje për 15% për shkak të rritjes së çmimit të shërbimeve botuese, por nën-pikat tjera të këtij grupi shënojnë ulje për shkak se aktivitetet e planifikuara janë gjashtëmujorin e ardhshëm. E gjithë kjo tregon se mjetet shfrytëzohen për qëllime dhe në mënyrë racionale, sipas Programit të LSHPM për vitin 2018. Me fjalë tjera, nga të dhënat e prezantuar më lartë mund të konkludohet se në këtë periudhë është realizuar Rezultat pozitiv financiar në shumë prej 1.402,8 mijë denarë, me çka konfirmohet realizim i vazhdueshëm i rezultateve pozitive financiare në LSHPM. Si rezultat i kësaj, Këshilli mbikëqyrës ka pranuar propozim-raportin financiar në tërësi me vërejtjet në arsyetimin që të qartësohen pikat dhe nën-pikat e caktuara që janë që janë me anulim të rëndësishëm në krahasim me vitin e kaluar dhe ka vlerësuar se Raporti në mënyrë reale ka pasqyruar gjendjen faktike financiare për realizimin e të hyrave dhe të dalave në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2018. Gjithashtu, vlerësimi është njëzëri se Raporti është përgatitur në mënyrë

solide, me qasje analitike, të përcjellë me dispozita të respektuara financiare dhe aktet interne të LSHPM, ndërsa posaçërisht nga të gjithë pjesëmarrësit është potencuar se shfrytëzimi i mjeteve është shfrytëzuar për qëllime, në mënyrë racionale, ekonomike dhe me kujdes.

Lidhur me Informacionin për Fondin solidar për anëtarësim dhe për ndihmën post-mortore për vitin 2017, hyrje të shkurtë dha kryetari i KM, Mitre Stojanovski. Në fjalën hyrëse, mes tjerash, ai theksoi se në vitin 2017, për këtë qëllim janë ndarë mjete në shumë të përgjithshme prej 441.213,9 mijë denarë, ndërsa për mbulimin e shpenzimeve për ndihmë post-mortore të 14.676 shfrytëzuesve të vdekur, janë shpenzuar 440.280 mijë denarë. Nga kjo del se shpenzimet për të vdekurit janë paguar në tërësi.

Është konstatuar se dobitë nga Fondi solidar në periudhën e deritanishme janë treguar si ndihmë e madhe financiare për shpenzime post-mortore të familjeve në ato momente të dhimbshme për më të afërmit, ndërsa gjithashtu është shumë me rëndësi edhe pagesa prej 30 denarëve e anëtarësisë që paraqet lëvizësin kryesor të organizimit pensional të gjeneratës së tretë, sepse me ato sigurohen shoqërimet, hapja e klubeve, revytë, garat sportive, aktivitetet humanitare, rekreacionet, krijime dhe një sërë aktiviteteve tjera... Përveç asaj duhet të theksohet edhe njëherë se pagesa për fondin solidar në shumë prej 120 denarë dhe anëtarësia në shumë prej 30 denarë është pëlqim vullnetar në pajtim me nenin 115 të Ligjit për SPIM.

## SHP KUMANOVË Përshtypje të paharrueshme nga vizita në Kosovë



Shoqata e pensionistëve të Kumanovës në kuadër të programit të vet vjetor për ekskursione, me të cilën janë përfshirë vizitat e vendeve për verime dhe vendet historiko-kulturore, më 5 gusht të këtij viti, ka organizuar vizitë në shpellën e mermertë të Gadimes në Kosovë. Herët në mëngjes, një grupë prej 60 pensionistëve prej më shumë nacionaliteteve është nisur përmes vendklimatit kufitar Bllacë deri në destinacionin e theksuar. Moti ishte i shkëlqyeshëm dhe me diell, sikurse i krijuar për udhëtim. Stacioni i parë për pushim gjatë rrugës ishte restoranti "Evropa 92" në hyrje të Ferizajt ku vizitorët u ndalën për të pirë kafe, ndërsa sipas planit kanë vazhduar në drejtim të shpellës së Gadimes.

Në hyrje të shpellës pensionistët u pritën nga guida, i cili në gjuhën shqipe detajisht u ka

shpjeguar bukuritë natyrore të shpellës. Nga ajo që panë dhe dëgjuan pensionistët mbetën të mahnitur. Duhet të theksohet se pensionistët kanë patur ndihmë të madhe gjatë sigurimit të përkthimit nga ana e kryetarit të Degës së Likovës, Nazim Emini, i cili u mundua për ata që nuk dinin gjuhën shqipe tu përkthejë të gjitha informacionet e hollësishme për shpellën. Pas shëtitjes prej tridhjet minutave duke parë bukuritë e shpellës, grupi u nisën në drejtim të Brezovicës, u patën mundësinë e rrallë të parë ujvarat e lumit Lepec, por edhe të thithin ajrin e freskët dhe të pastër malor. Mbi të gjithash, ekskursioni kaloi në një atmosferë të këndshme dhe të mahnitshme, ndërsa pensionistët nga Kumanova u kthyen të kënaqur dhe të gëzuar, me përshtypje të bukura dhe përjetime të paharrueshme.

## SHIP-SHPI TETOVË Llogaridhënia, garancë për sukses

Së paku dy herë në vit organet kompetente në Shoqatën e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensionit invalidor në Tetovë shqyrtojnë realizimin e programit vjetor për punë dhe në këtë mënyrë i analizojnë shkaqet për vështirësitë eventuale, problemet dhe mangësitë që janë paraqitur gjatë asaj periudhe. Kjo praktikë zbatohet tash një kohë të gjatë, ndërsa ka për qëllim jo vetëm informimin për atë që ka ndodhur, por edhe për ndërmarrjen e masave përkatëse për aktivitetin e pasur. Duke realizuar këtë praktikë, është bërë një rishikim i gjysmëvjetorit të parë të vitit aktual. Gido Bojçevski, kryetar i SHIP-SHPI Tetovë informoi se tek të gjithë këto aktivitete, janë përfshirë edhe kryetarët e organizatave lokale, kontributi i tyre gjithashtu është i madh. Në qendër të vëmendjes gjatë kësaj periudhe është furnizimi i anëtarësisë me dru për ngrohje. Kjo shoqatë tash më dhjet vjet lidhë marrëveshje me "Pyjet e Maqedonisë" - filiali "Llopushnik" Kërçovë, përmes së cilës sigurohen mbi 2.000 metra kub dru për ngrohje për të gjithë të paraqiturit mbi 300 invalidë të punës dhe pensionistë familjar.

"Duke u nisur nga standardi i pensionistëve, mundësojmë që pagesa të realizohet me këste, ndërsa transporti i druve për ngrohje deri tek shtëpitë e përdoruesve bëhet falas. Ky është kontributi ynë në furnizimin me dru për ngrohje me çmim më të ulët, dhe pastaj të lehtësojmë transportin deri në shtëpitë e tyre", shtoi Bojçevski. Për gjashtë muajt e parë tash më janë siguruar dhe dorëzuar rreth 400 metra kub, ndërsa për një kohë të shkurtë do të dorëzohet tërë sasia e kontraktuar.

Gjithashtu, SHIP-SHPI Tetovë ka lidhur marrëveshje për shërimë në banjë me të gjitha banjat në Maqedoni me lirim prej 10 për qind të çmimit të rregullt të pensionit. Bojçevski thotë se gjatë muajve të ardhshëm do të organizohen gara sportive, ekskursione, shënim të festave, posaçërisht do të ketë aktivitete me rastin e javës së personave me hendikep. Megjithatë, më aktual do të jenë aktivitetet zgjedhore, që planifikohen të mbahen në tre muajt e fundit të vitit aktual. Zgjedhjet do të mbahen tek të gjitha organizatat lokale, ndërsa ka fundi i muajit dhjetor edhe mbledhja konstituive e përbërjes së re të Kuvendit. (G.E.)



# Evropa



Nga  
Nazim RASHIDI

Janë plot humor por dhe njëkohësisht tejet thumbuese një sërë reagimesh, batuta apo dhe barcaleta, krijime të shkurtra dhe plot kuptim që shfaqen e pastaj përhapen në rrjetet sociale. Me bien në sy shpesh, të cilat për veç se ta vënë buzën në gaz shprehin dhe përplot ironi, të vërtetë e reale, për realitetin tonë sidomos ndaj Evropës. Marrin edhe më shumë kuptim këto thumba, që vinë në formë të një folklori modern, sepse mu tani Maqedonia flet shumë për Evropën, integrimet për shkak të referendumit për emrin që do të mbahet në fund të shtatorit. Nuk ka njeri që se ka gojën plot Evropë por nga ana tjetër jo dhe veprimet.

Dhe po, nuk kam takuar njeri që nuk do të "shkojë" në Evropë edhe figurativisht por edhe fizikisht, por nga ana tjetër, disi mbetemi në vend. Kjo për shkak se institucionet ngecin në reformimin e tyre por edhe për shkak të vetë njerëzve që se bëjnë dot ndryshimin që të sillen evropiançe, edhe pse gojën plot Evropë edhe ata e kanë.

Lëvizja nëpër rrugë në këmbë e veturë, gjatë verës është më dinamike. Ka përplot të ardhur, turisë apo dhe mërgimtarë. Dhe kur do të marrësh pak ajër, sidomos kur je me veturë dhe hap dritaren e nxjerr kokën jashtë, atë që sheh, është plehra. Gjësente të hedhura, mbeturina produktesh, etj dhe të gjitha këto nga vetë njerëzit.

Të sqarohem. Më duket skandalozë që qytetet tona, e sidomos disa pamje që qarkullonin me mbeturina të pa mbledhura nga ndërmarrjet që duhet ta bëjnë atë punë. Më duket e pa shpjegueshme letargjia e drejtuesve të komunave që pas zgjedhjeve u rehatuan sa gjerë e gjatë, e nuk merren me përmirësimin e veprimeve elementare, siç është pa pastërtia. Më duket e pafalshme që pranë rrugësh, mes ndërtesash dhe shtëpive, të kundërmojë erë e rëndë dhe mbeturinat të rrinë aty me ditë.

Por ama më duket edhe e pa falshme kur ne, njerëzit, pa pikë kujdesi e bëjmë edhe këtë vetë.

E bëra gjithë këtë parantezë, sepse në një moment me gojë plot Evropë, kurse me rrugët plot mbeturina, kontribuesit e kësaj pamje s'janë vetëm institucionet.

Një makinë para meje, hapi dritaren dhe hodhi shishen pa pikë kujdesi. Shishja, e plastikës, ra në xhamin tim. Shoferi e pa skenën dhe u ndal. U ndala dhe unë. Sigurisht më kërkoi falje. Por kjo nuk për mua nuk kishte më rëndësi. Zemërimi më i madh

erdhi kur kuptova, se shishen e kishte hedhur bashkudhëtari, të cilit shoferi i zemëruar dhe turpërua i tha: "Po atje në Evropë do e kishte hedhur shishen nga dritarja?". Në fakt nuk do ta kishte hedhur.

Dhe mbase jemi peng i një rrethi vicioz, ku nëse rrugët nuk janë të pastra, atëherë edhe ne, sillemi me kujdes. Dhe kur janë plot plehra, atëherë s'na bën përshtypje nëse do ketë një shishe më pak apo më shumë.

Por kjo duhet të ndalojë. Mendoj, se aq sa mundet të ketë një reflektim personal. Ejjj, se ja hymë në Evropë, si do sillemi pastaj? Miti që sjell Evropa, për të cilin të gjithë kontribuojmë, në fakt nuk do sjellë ndryshime brenda nesh. Këtë ndryshim të një sjellje evropiane duhet ta bëjë secili vetë. Mbeturinat në rrugë, papastërtia janë gjëja më banale e mundshme, por megjithatë është dhe treguesi i sjelljes të secilit prej nesh dhe së bashku si shoqëri për norma dhe sjellje të cilat i duam prej tjerëve dhe nuk i zbatojmë vetë, nëse ndodh kjo. Kam dëgjuar dhe dëgjoj plot ankesa për njerëzit e zyrave dhe normale kur shkon të kryesh punë e nuk mbaron punë, bëhesh gjithë nerva. Shpjegimi është i thjeshtë: "këto gjëra në Evropë nuk ndodhin".

Dhe e vërtetë. Administratat e të gjitha niveleve janë më efikase. Tani

përdoret dhe teknologjia dhe mbase dhe s'ka nevojë as fizikisht të jesh prezent, për nxjerrje dokumentesh, pagesash etj. Aq folën këta njerëzit e zyrave, sa edhe vetë, kush e di sa herë kam shkruar, folur e jam ankuar.

Por duke marrë shkas, nga rasti i shishes të hedhur e mbeturinave, që i bëjnë vetë njerëzit dhe janë plot ankesa për mospastrimin, po e bëj pyetjen edhe ndryshe: Po këta që ankohen, ne, unë, për njerëzit e zyrave, nëse ishte rasti i kundërt, a do e kishim kryer punën evropiançe? Në fakt, këtu qëndron e gjithë përgjigjja. Sa në fakt ne vetë, secili, në të gjitha punët që kryejmë, jemi të përpiktë, jemi korrekt dhe kemi përgjegjësinë ndaj punës e tjetrit kur jemi në pozita të kundërta.

Kam përshtypjen e s'jemi. Sepse para gjë që të bën Evropian është përgjegjësia. Sidomos ndaj vetes, të tjerëve dhe vetë vendit.

Dhe e shkruaj gjithë këtë tekst, sepse ai i rikthyeri, cili do që ishte, në fakt as u turpërua e as kërkoi faljen për veprimin që bëri. Nuk u ndie keq as për njeriun e tij të afërt me të cilin udhëtoi për shkak se e vuri në pozitë të vështirë. Normal që të tilla ndjesish s'kishte as ndaj meje, por fatkeqësia ishte se u mjaftua me fjalinë: "po hë mo, se këtu kështu bëjnë të gjithë. Ja shikoni rrugën gjithë mbeturina!".

**Ne më duhet të sillemi si në Evropë. Ajo Evropa e shkretë nuk do vijë vetë e duke na ndryshuar si me çip mendësinë. Evropa vjen duke bërë edhe më të voglën gjë, mos të hedhim mbeturina në rrugë. Pastaj bashkë do bërtasim që autoritetet të merren me pastrimin siç duhet e deri tek drejtimi i institucioneve edhe më të larta**



Dhe edhe një të qeshur, u fut në makinë dhe shikonte telefonin.


Të vërteta mbase thoshte. Por nuk mund të mos reagojmë ndaj sjelljeve të tilla. Tonat e të të afërmve tanë.

Se ai nuk sillet kështu në Evropë. Po ai edhe s'ka rëndësi. Ne më duhet të sillemi si në Evropë. Ajo Evropa e shkretë nuk do vijë vetë, e duke na ndryshuar si me çip mendësinë. Evropa vjen duke bërë edhe më të voglën gjë, mos të hedhim mbeturina në rrugë. Pastaj bashkë do bërtasim që autoritetet të merren me pastrimin siç duhet e deri tek drejtimi i institucioneve edhe më të larta. Sjelljet e institucioneve i bëjnë njerëzit. E njerëzit jemi ne, të gjithë, që nga punëtori e deri tek ministri, që nga fëmijët e deri tek prindërit. Mendoj se ka ardhur koha, që Evropën dhe vlerat e saj, të thjeshta e filozofike të fillojmë t'i gjejmë e t'i zbatojmë një herë vetë.

Pjesa tjetër e rrugëtimit pastaj do jetë më e lehtë. Sepse mjafton vetëm një parim: mos ia hedh shishen tjetrit, nëse kjo nuk të pëlqen edhe ty. Ose mos bëj veprime që të mërzisin, që nga puna, përditshmëria e deri tek familja, që nuk do doje të tjerët të t'i bëjnë ty. Kaq e thjeshtë është, kur e fillo Evropën nga vetja.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 29 gusht | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



# Universiteti i Kombit dhe Kombi i Universitetit



Nga  
Selam SULEJMANI

Universiteti i Tetovës për shqiptarët e vendit tonë dhe më gjerë paraqet "Atdheun" e tyre arsimor, shkencor dhe kulturor. Aleanca, ndërveprimi, por mbi të gjitha besnikëria ndaj njëri-tjetrit daton që në përpjekjet e para për themelimin e tij në vitin historik 1994 e deri në ditët e sotme. Ky Universitet, të cilin kombi ynë me të drejtë e quan vatra e dritës dhe diturisë, me punën titanike, veprimtarinë e bujshme arsimore-shkencore, për brezat e rinj nga trojet etnike shqiptare në RM dhe më gjerë, është shndërruar në tempullin e edukimit, arsimimit dhe përparimit mbarëkombëtar.

Sikurse theksonte edhe themeluesi dhe Rektori i parë e historik i UT-së, Prof. Dr. Fadil Sulejmani, "Universiteti i Tetovës ka një histori sa të lavdishme e të bujshme aq edhe të hidhur e të dhimbshme, meqë për lindjen dhe ngritjen e këtij Universiteti shqip u derdh shumë lot, gjak e djersë; pati shumë shpenzime financiare dhe dëme materiale, maltretime, ndjekje, rrahje, arrestime, izolime, burgosje dhe vrasje të shqiptarëve; u bastisën, u plaçkitën dhe u rrënuan shumë shtëpi të tyre vetëm e vetëm pse ne deshëm të mësojmë, të lexojmë e të shkruajmë në gjuhën tonë amtare

Ata sot lexojnë për rangime universitetesh (tërësisht të manipuluar), por me kohë e kanë mësuar se kur kombi të rangon - beson edhe Kina shndërrohet në pakicë para furisë, entuziazmit dhe vendosmërisë së të rinjve shqiptarë për t'u edukuar dhe arsimuar në Universitetin e krenarisë dhe lavdisë kombëtare - Universitetin e Tetovës



shqipe. Për këtë Universitet dhe për këtë gjuhë ranë dëshmorë shumë studentë, punëtorë dhe qytetarë shqiptarë: Bedri Halimi, Zejadin Zimberi, Xhemil Abduramani, Burim Hyseini, Abdylselam Emini e të tjerë, gjaku i të cilëve është bërë dritë dhe sot ndriçon rrugën e diturisë sonë".

Mirëpo, këto humbje rilindësi ynë i quan të vogla para fitores së

madhe që arriti Universiteti i Tetovës dhe populli shqiptar në atdheun e vet në Maqedoni. Sipas tij, fituan gjërat e shenjta të popullit: shkenca, arsimit, arti dhe kultura mbi dhunën. Triumfoi dituria mbi barbarinë, shkolla mbi obskurantizmin mesjetar. Edhe pse nuk mësohet në tekstet e shkollave fillore dhe atyre të mesme, historia e Universitetit të Tetovës është e njohur për fëmijët, të rinjtë dhe brezat tjerë, sepse të gjithë i bashkon misioni dhe vizioni i tij, ndër vite i kanë shërbyer njëri-tjetrit dhe në këtë mënyrë kanë ndërtuar raporte, marrëdhënie dhe bashkëpunim të çeliktë për ta ngritur këtë KALA të pamposhtur të arsimit shqip - Universitetin e Tetovës.

Këtë javë, në Universitetin tonë zhvillohet afati i parë i regjistrimit për vitin akademik 2018/2019. Maturantët shqiptarë nga vendi, Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, Lugina e Preshevës dhe vëllezërit tanë të diasporës kanë vërshuar drejt dyerve të fakulteteve tona. Ata, edhe pse janë të vetëdijshëm për realitetin e ri në të cilin funksionon ky institucion, e sjellin në vëmendje sakrificën e gjeneratës së parë të studentëve dhe të pedagogëve, guximin dhe trimërinë që treguan, duke mbajtur ligjëratat e para mësimore para ty-

tave të automatikëve të forcave policore sllave.

Kandidatët - studentët e ardhshëm të UT-së, sot aplikojnë përmes sistemit online, por nuk i harrojnë fjalët e profesor Fadil Sulejmanit: "Ne duam lapsin dhe fletoren, nuk duam dhunë". Ata i shohin me sytë e tyre auditorët bashkëkohorë ku do të studiojnë, por nuk i harrojnë prindërit, vëllezërit që shtëpitë e tyre ia falën UT-së për mësonjëtorë. Sot i njohin emrat e profesorëve, por për ata i paharrueshëm mbetet kontributi i pishtarëve universitarë, profesorëve nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët në momentet më kritike të Universitetit të Tetovës dhe në kohën kur ai kishte nevojë më të madhe për kuadro mësimorë, iu përgjigjën me përkushtim thirrjes së këtij Universiteti, duke dhënë aty rregullisht kontributin e tyre profesional-shkencor, përkundër presionit policor dhe vështirësive të tjera.

Studentët e rinj të vitit akademik 2018/2019 do të përfitojnë shumë lehtësime në Universitet, si bursa, trajnime të ndryshme profesionale sidomos përmes programeve arsimore ndërkombëtare, por nuk do ta harrojnë kontributin e miqve ndërkombëtarë të UT-së, që daton nga 1994, sidomos përfaqësuesin e zyrës amerikane në

Shkup, profesorin Viktor Komaras, i cili intervenoi te qeveria që ta largojë policinë nga Universiteti, kur ajo ndërhynte vazhdimisht në hapësirat universitare, pengonte mësimin, i shante dhe i rrihte studentët, duke ua shqyer indeksat, librat e fletoret. Gjatë vitit akademik do të kenë mundësi të mësojnë më shumë për bashkëpunimin që UT gëzon me universitetet serioze ndërkombëtare, por jam i sigurt se ata përjetësisht do ta kujtojnë AMERIKËN dhe popullin amerikan, sepse Universiteti i Tetovës marrëveshjen e parë për bashkëpunim ndëruniversitar e nënshkroi me Universitetin Xhorxh Vashington të SHBA-ve. Ata do të studiojnë për arsim, shkencë, kulturë, do të luftojnë për dije, por nuk do t'i harrojnë studentët e po këtij Universiteti që edhe luftuan në vitin 2001 nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Ata sot lexojnë për rangime universitetesh (tërësisht të manipuluar), por me kohë e kanë mësuar se kur kombi të rangon - beson edhe Kina shndërrohet në pakicë para furisë, entuziazmit dhe vendosmërisë së të rinjve shqiptarë për t'u edukuar dhe arsimuar në Universitetin e krenarisë dhe lavdisë kombëtare - Universitetin e Tetovës.

# Qeveria mashtruese e Italisë



Nga  
Bernd RIEGERT

Qeveria populiste e Italisë bën atë që dinë të bëjnë më mirë populistët: Të shtrembërojnë faktet, të ndezin emocionet me fajësime të pavërteta e parrulla të thjeshta e të nxjerrin kështu kapital politik. Ministri italian i Ekonomisë, Luigi di Maio pretendon se Italia paguan çdo vit 20 miliardë euro në buxhetin e BE. Kjo nuk është e saktë, neto Italia ka paguar vetëm 3,3 miliardë euro. Eurokomisioneri i BE për buxhetin, Günther Oettinger e korrigjoi këtë të dhënë të di Maio. Lideri i Lëvizjes Pesë Yjet kërcënon se do të ndërpresë kontributet italiane në buxhetin e BE. Kjo është e para antiligjore, dhe tjetra një kërcënim pa stil, që BE e ka hedhur menjëherë poshtë. Di Maio dhe ministri i Brendshëm, Matteo Salvini pretendojnë më tej, se BE ka premtuar t'ia marrë Italisë emigrantët që vijnë aty.

Edhe kjo është e gabuar. Një ujdë të tillë nuk e kanë arritur asnjëherë shtetet anëtare, që duan të izolojnë nga migrantët. Disa kanë sinjalizuar vetëm gatishmërinë vullnetarisht për të marrë disa prej tyre. Më shumë solidaritet nuk ka.

Por më absurd është pretendimi, se Komisioni i BE në Bruksel është përgjegjës për pranimin e refugjatëve. Di Maio dhe Salvini e dinë shumë mirë, se përgjegjës për këtë janë shtetet anëtare. Solidaritet nuk ka as mes qeverive populiste. Edhe autokrati në Danub, kryeministri hungarez, Viktor Orban refuzon, megjithë kërkesën italiane të marrë edhe një emigrant të vetëm. Salvini, që me temën e refugjatëve vazhdon të bëjë fushatë zgjedhore të pandërprerë, megjithëse shifra e të ardhurave është shumë larg gjendjes së krizës, ka gjetur një recetë antihu-

Populistët dhe nacionalistët në Romë nuk pranojnë të marrin më migrantët dhe shkelin me këtë rregulloret europiane. Nëse Brukseli vazhdon ende të bëjë sehir, do të hyjë në një krizë të re



mane të thjeshtë: Përmes refuzimit të çdo lloj anijeje me migrantë në bord, ai kërkon të izolojë dhe të kërcënojë me çdo çmim. "Italia e para" - po zbatohet pa marrë parasysh pasojat.

Fakti që Salvini dhe funksionarët e tij bllokuan edhe një anije italiane si "Dicioitti" është e paprueshme për drejtësinë italiane. Ajo ka filluar hetimet për heqje lirie ndaj Salvinit, që nuk do shkojnë shumë larg me siguri, por të paktën kjo është një shenjë e qartë e rezistencës kundër kursit të populistëve në Romë. Reagimi i Salvinit pritej. Hetimet ai i quan "turp", se bëhet fjalë për Italinë dhe "nder", sepse fisnikërojnë luftën e tij kundër sistemit. Sulme të tilla joserioze ndaj drejtësisë i njohim ndërkohë nga Shtëpia e Bardhë, por ato nuk duhet të kthehen në përditshmëri edhe në Itali!

E vërtetë është po ashtu se shtetet anëtare, edhe pas tre vjetësh nuk kanë arritur të bien dakord për një reformë të sistemit të azilit dhe një shpërndarje të drejtë të migrantëve. Kjo është dobësia që shfrytëzohet deri në fund nga popu-

listët: BE bëhet fajtorë për çdo gjë. Ky reagim impulsiv është i gabuar. Problemet janë komplekse dhe Italia vetë ka bërë pjesë tek vendet që kanë penguar reformimin e procedurave europiane. E palejueshme është që të veprosh në mënyrë të veçantë tërësisht, duke shkelur rregullat europiane e ato humane, siç po bëjnë Matteo Salvini dhe Luigi di Maio tani. Me këtë ata çënojnë edhe themelet e BE. Por me kërcënime nuk kanë për të shkuar larg, as nuk duhen lejuar të shkojnë larg. Edhe në negociatat për buxhetin nga viti 2012-2017, italianët mund të shkaktojnë shumë probleme. Mund të llogarisim se populistët dhe radikalët e djathtë do të rrezikojnë edhe daljen nga eurozona dhe BE për të realizuar vullnetin e tyre. Pas Brexit, Polonisë dhe Hungarisë po krijohet me shpejtësi një vatër e re krize për BE. (DW)





## Çdo i pesti telefon mobil në botë është fals

Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale njoftoi se sipas studimit të fundit numri i pajisjeve të rreme është në rritje të konsiderueshme. Gjegjësisht, është vërtetuar se falsifikimi i aseteve teknike brenda BE-së çdo vit e shkurton buxhetin me rreth 60 miliardë euro. Sipas raportit zyrtar, në vitin 2016 gjithsej 41.3 milionë pajisje të falsifikuara, në vlerë prej 670 milionë eurosh, kaluan përmes kufijve të BE-së. Nga këto, 1 059 855 janë telefona celularë, duke përfshirë edhe pjesët e tyre. Ky trend nuk është vetëm në Bashkimin Evropian, por edhe në mbarë botën. Sipas të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, në vitin 2017 çdo e pesta pajisje mobile në botë është false. Për të njohur dallimin nëse blini një pajisje origjinale ose false, duhet të keni një sy skeptik, sepse në shikim të parë, origjinali dhe falsifikimi duken të njëjta. Një pamje e detajuar e pajisjes, si dhe kontrollimi i numrit IMEI, janë mënyrat më efektive për të njohur se cili telefon është origjinali dhe cili kopje. Gjithashtu mund të vizitoni faqen përkatëse të internetit dhe mënyra më e thjeshtë për të siguruar që ju keni blerë një pajisje origjinale është të punoni me tregtarët e autorizuar, të cilët do t'ju caktojnë një kartë garancie.



## Çdo e katërta shtëpi është bosh në Bullgari

Në Bullgari ka më shumë se 1.2 milionë banesa të pabanuara, sipas Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Në qytete, rreth një në katër shtëpi janë bosh, ndërsa në fshatra, shifra është afër 43 për qind, kryesisht për shkak të shpopullimit. Përqindja e banesave të zbrazëta në rrethin e Sofjes është shumë e lartë, në 48.2 për qind, ndërsa në Pernik shifra është 44.9 për qind dhe në qarkun Burgas, 43.7 për qind. Duke folur në një intervistë televizive, zëvendësministri i Zhvillimit Rajonal, Malina Kroumeva, tha se kishte disa arsye pse shtëpitë ishin bosh. Njëra ishte se ka pasur mosmarrëveshje rreth pronës së trashëguar, ndërsa këto mosmarrëveshje po vazhdonin, banesat mbeten bosh. Një arsye tjetër ishte se bullgarët që shkojnë jashtë vendit nuk i shesin ose japin me qira shtëpitë e tyre.

Grupi "New Swiss Cow", i cili këshillon mbi 100 fermerë, po përpiqet të zhbëjë përpjekjen 50-vjeçare për gjedhë më të mëdha në Zvicër. Sipas tyre, kjo gjë bazohet mbi premtimin e rremë se do të sjellë përfitime më të mëdha ekonomike nëse prodhon më shumë qumësht.

Teksa kullotat e thara po i detyrojnë fermerët në të gjithë Europën të blenë ushqime më të shtrenjta për gjedhët e tyre të uritura, një shoqatë zvicerane e bulmetit ka gjetur një zgjidhje të pjesshme: kafshë më të vogla.

Grupi "New Swiss Cow", i cili këshillon mbi 100 fermerë, po përpiqet të zhbëjë përpjekjen 50-vjeçare për gjedhë më të mëdha në Zvicër. Sipas tyre, kjo gjë bazohet mbi premtimin e rremë se do të sjellë përfitime më të mëdha ekonomike nëse prodhon më shumë qumësht. Por edhe pse është e vërtetë se tashmë kjo racë e përhapur në Zvicër prodhon më shumë qumësht, lopët më të vogla prodhojnë në një mënyrë më eficiente duke kërkuar më pak ushqim dhe hapësirë. Ato gjithashtu kanë nevojë për më pak vizita tek veterineri, se sa kushërinjtë e tyre të modifikuar gjenetiki-sht.

Që prej viteve '60, lopët zvicerane janë rritur deri në 800 kilogramë, duke u përzier me demat amerikanë. Pothuajse gjysma e 537 mijë gjedhëve në Zvicër janë të racës simmental, e cila është miksuar me Red Holstein të SHBA. Kjo përzierje racash ndihmoi në dyfishimin e prodhimit vjetor të qumështit për kafshë në 7400 litra. Megjithatë, kafshët më të vogla prej 500 deri në 600 kilogramë mund të prodhojnë në mënyrë më eficiente 6 mijë deri në 7 mijë litra qumësht. Ky parim vlen edhe për racat e tjera të lopëve përtej kufijve të Zvicrës. Megjithatë, në Zvicër ka një arsye shtesë për të zëvendësuar lopët: gjedhët më të

# LOPËT ZVICERANE, MË TË SHËNDOSHA SE Ç'DUHET. FERMERËT MENDOJNË ZËVENDËSIMIN



lehta mund të arrijnë më lehtë në kullotat alpine. Sfida pritet të jetë më e madhe për fermerët evropianë këtë vit edhe për shkak se thatësitat në Gjermani kanë reduktuar

ndjeshëm rendimentin e grurit. Të korrat këtë vit pritet të jenë më të paktat në 24 vite, çka do të thotë se çmimi i ushqimit për lopët e derrat do të rritet këtë vit.

## Pasaporta shqiptare, më shumë e lanë se sa e fituan



Pasaporta shqiptare, me vetëm 67 shtete ku mund të lëvizësh pa viza dhe 42 ku viza merret në mbërritje, sigurisht që nuk është ndër më të fuqishmet në botë. Në fakt ajo qëndron pas edhe asaj të Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi.

Gjithsesi, ajo është shumë e vlefshme për shqiptarët e Kosovës, të cilët kërkojnë të lëvizin lirisht përtej 15 vendeve që u mundëson pasaporta e tyre. Kjo është një nga arsyet kryesore për 316 rastet e personave që kanë fituar shtetësi shqiptare

gjatë vitit 2017. Kjo shifër është madje në rritje me 12.5% krahasuar me një vit më parë.

Por ky nuk është treguesi i vetëm, pasi në rritje shfaqet edhe numri i personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Për vitin që lamë pas këta individë rezultuan në 651 persona, me një rritje me 1/3 nga viti në vit. Pra duket se shifrat e lënies së shtetësisë tejkalojnë ato të marrjes prej disa kohësh tashmë. Një nga arsyet për këtë braktisje të pasaportës shqiptare është edhe marrja e shtetësisë së huaj të emigrantëve që jetojnë në vende si Gjermania, të cilat nuk lejojnë dyshtetësinë për qytetarët nga vendet jo të BE.

Nëse marrim parasysh efektin që do të ketë liberalizimi i vizave me zonën Schengen për qytetarët e Kosovës, raporti marrje/lënie shtetësie pritet të thellohet.



## Porsche i aksidentuar para 31 vitesh shitet për 500 mijë dollarë

Në ankandin e mbajtur në Monterey të SHBA-së, Porsche 959 Comfort i aksidentuar para 31 vjetëve, në vitin 1987, ndryshoi pronarin për 467.000 dollarë. Kjo nuk ndodhë kaq shpesh që në ankandin e makinave të shtrenjta klasike ka një kopje të aksidentuar. Megjithatë, në ankandin tradicional të këtij viti në kuadër të "Javës së Automjeteve të Monterey", Porsche 959 i dëmtuar gjithashtu ofrohet në versionin Comfort. Në total, vetëm 294 kopje të 959 komfort ishin bërë, dhe



makina për të cilën blerësit konkurruan në ankand kishte 6.000 km të kaluara. Shtëpia e ankandeve Mecum, e cila ofroi

një makinë për shitje, e kishte vlerësuar më parë vlerën prej 450.000-550.000 dollarë, dhe përfundimisht "arriti" në një shumë prej 467.000 dollarë. Duke pasur parasysh se njësitë e ruajtura të Porsche 959 Comfort në ankand tejkalojnë 1 milion dollarë, klienti sigurisht kishte llogarënë e tij përse për këtë makinë kishte paguar gjysmën e kësaj shume. Sa i përket automjetit të rrallë, pritet që sapo të restaurohet, ky çmim do të rritet, në mënyrë që të jetë një investim fitimprurës.



## Përse meshkujt nuk kanë celulit?

Burrat dhe gratë janë të ndryshëm edhe në shpërndarjen e yndyrës në trup. Filluar nga kjo e fundit, Meshkujt duket se nuk e njohin problemin e shëmtuar të celulitit në sajë të disa dallimeve fiziologjike në lidhje me gratë. Tek gratë, shtresat e yndyrës priren të zhvillohen në sipërfaqe, në drejtim të lëkurës, dhe kështu çdo "akumulim" është menjëherë i dukshëm. Tek burrat, nga ana tjetër, morfologjia e indit dhjamor shkakton që yndyra të zhvillohet më thellë, në drejtim të shtresës muskulare, pa ndryshuar estetikën e lëkurës. Pjesa tjetër siguri-sht që e zë mungesa e estrogenit, hormonet që tek femrat ngadalësojnë eliminimin e ujit, yndyrave dhe mbeturinave, duke favorizuar akumulimin (në mpiksje) në zona të caktuara të trupit. Nëse meshkujt janë imun ndaj celulitit gjërat ndryshojnë kur ata nuk tregojnë kujdes me ushqimin. Kaloritë tepërta dhe yndyrnat tek meshkujt përqendrohen më së shumti në zonën e barkut, gjë të cilët në një moshë të caktuar të gjithë e kanë. Dhe kini kujdes: barku tek meshkujt është pothuajse gjithmonë për shkak të një diete të keqe dhe të tepruar.

Programi i biodiesel filloi si program eksperimental vitin e kaluar. Por tashmë kjo ka ardhur duke u përmirësuar për të mbuluar të gjitha 85 restorantet e McDonald's në Mumbai

## KAMIONËT NË INDI PO PËRDORIN SI KARBURANT VAJ GATIMI NGA RESTORANTET E MCDONALD



A e keni menduar ndonjëherë se çfarë ndodh me vajin që përdoret për të gatuar ushqime të skuqura? E pra, në Indi kjo përdoret si lëndë djegëse. Mjeshtri Franchissee për restorantet e McDonald's në perëndim dhe në jug të Indisë, Hardcastle Restaurants Pvt Ltd (HRPL), është duke përdorur si karburant vajin e përdorur për gatim në mënyrë që të fuqizojë flotën e saj të kamionëve të shpërndarjes në Mumbai.

Programi i biodiesel filloi si program eksperimental vitin e kaluar. Por tashmë kjo ka ardhur duke u përmirësuar për të mbuluar të gjitha 85 restorantet e McDonald's në Mumbai. Më shumë se 35.000 litra vaj gatimi të përdorur po shndërrohen në bionaftë çdo muaj, duke ndihmuar për të kursyer më shumë se 420.000 litra naftë bruto çdo vit. HRPL është një degë e Westlife Development Limited, e cila është e listuar në Bursën e Bombeit. Që nga shtatori 2017 Westlife Development Li-

mitet ka operuar, nëpërmjet HRPL, 265 restorante të McDonald's në 36 qytete. "Ne besojmë fuqimisht në mbrojtjen e mjedisit tonë dhe kjo e bën qëndrueshmërinë dhe konservimin një pjesë të rëndësishme të veprimtarive tona në Indi", tha Amit Jatia, nënkryetar i Westlife Development, në një njoftim për shtyp të hënën. "Ky është vetëm fillimi dhe ne do të vazhdojmë të mbrojmë mjedisin

në vitet në vijim", shtoi Jatia.

Masa u mirëprit edhe nga Shoqata Bionaftë e Indisë. Presidenti i saj, Sandeep Chaturvedi, tha se shoqata po inkurajonte "të gjitha kompanitë ushqimore të mësojnë nga kjo iniciativë dhe ta zbatojnë atë në modelin e tyre të biznesit." McDonald's ka plane ambicioze kur është fjala për qëndrueshmërinë dhe mjedisin. Në U.K., për shembull, kamionët e

saj të shpërndarjes janë mundësuar nga bionaftë për 10 vjet. Globalisht, gjigandi i ushqimit të shpejtë dëshiron të shkurtojë emetimet e gazrave të serrave në lidhje me restorantet dhe zyrat e saj me 36 për qind deri në vitin 2030, duke përdorur vitin 2015 si një vit kryesor. Ajo ka thënë se do të bashkëpunojë me të dy kompanitë dhe furnizuesit për të punuar në këtë drejtim.



## Piktura prej 165.000 funta rezulton të jetë e rremë!

Një pikturë e blerë me një çmim prej 165.000 funta, artisti i së cilës mendohet se ishte William Nicholsoni është hedhur poshtë si e rremë. Kjo pikturë tani konsiderohet si e pavlefshme. Piktura titullohej "Glass Jug With Plates And Pears" dhe u ble në vitin 2006 me mendimin se ishte origjinale. Prezantuesja e pikturave Fiona Bruce tha se ishte e tronditur pasi rasti ishte tepër i fortë. Ndërsa pronari Lyn tha se piktura ishte dashuri me shikim të parë dhe nuk kishte pasur dyshime për origjinalitetin e saj kur e kishte blerë. Por kur një katalog i punës së Nicholosit u botua nga "Reed" në vitin 2011, piktura e Lyn nuk përfshihej. Tregtari i arteve ndërkombëtare Philip Mold tha se ky është një nga hetimet më bindëse teknike që kanë bërë një fotografi.

## Jo më llamba halogjene! Europa ndalon hyrjen e tyre

Pothuaj pas 60 viteve të ndriçimit të shtëpive dhe të rrugëve tona, llambat halogjene do të ndalohen në Europë nisur nga 1 shtatori. Rezervat e mbetura ende mund të shiten, megjithatë do të përjashtohen kapsulat, lineare dhe me tension të ulët të përdorur në dritat e furrës. Përdorimi i dritave LEDs bëhet me qëllim uljen e emetimeve dhe faturave të energjisë, sipas industrisë, aktivistëve dhe ekspertëve. LEDs konsumojnë pesë herë më pak energji se llambat halogjene dhe largimi i tyre do të parandalojë më shumë se



15 milion ton emetime të karbonit në vit, një sasi e barabartë me përdorimin vjetor të energjisë elektrike të Portugalisë. Gjithashtu, llambat halogjenë zgjasin mesatarisht vetëm dy vjet, krahasuar me LED-et që kanë një

jetëgjatësi prej 15-20 vitesh. Por ka edhe mendime "kundër" heqjes së këtyre llambave.

"Përpjekja e BE për të ndaluar llambat me halogjen është e gabuar sepse konsumatorët do të vuajnë financiarisht dhe është

gjithmonë shtresa e varfër që vuan më shumë nga këto lloj politikash". Konsumatorët duhet të kenë lirinë e zgjedhjes dhe nuk duhet të imponohen nga BE", tha Jonathan Bullock, zëdhënësi i Ukip në Parlamentin Europian.

Një llambë halogjene mund të jetë më e lirë për tu blerë fillimisht por shpenzimet e energjisë elektrike do të jenë më të shtrenjta. Kursimet e konsumatorëve do të rriten sepse LED-et zgjasin shumë më shumë se llambat me filament dhe përdorin shumë më pak energji.



Opozita në Kosovë po i vazhdon konsultimet në kuadër të përpjekjeve për të siguruar numrin e mjaftueshëm të votave për ngritjen e mocionit të mosbesimit në Kuvend ndaj Qeverisë së Kosovës

Partitë opozitare, vazhdojnë të kontestojnë legjitimitetin e Qeverisë aktuale të Kosovës, por zyrtarisht nuk kanë ndërmarrë ndonjë nisim drejt ngritjes së ndonjë mocioni të mosbesimit, ngase u mungojnë votat e nevojshme për ta rrëzuar 'Qeverinë Haradinaj'. Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, tha për Radion Evropa e Lirë, se pas zhvillimeve të fundit politike, e vetmja mundësi për të ndryshuar gjendjen në vend është rrëzimi i qeverisë aktuale me anë të mocionit të mosbesimit. "Mocioni i votëbesimit është rruga e vetme për të nxjerrë vendin nga kriza. Sot kam pasur takime me kryetarin e grupit parlamentar të Vetëvendosjes edhe me kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialdemokrate. U kam qartësuar atyre që grupi ynë parlamentar do të takojë formalisht këto dy grupe

# NË KËRKIM TË TRI VOTAVE PËR TA RRËZUAR QEVERINË



të tjera parlamentare për të bërë gati mocionin e votëbesimit sa më parë", tha Hoti. Ai tha se kriza politike në vend është thelluar edhe me shumë javët e fundit.

Hoti ka përmendur ndërhyrjet politike, siç i ka quajtur ai, në sistemin e drejtësisë nga ana e Qeverisë së Kosovës si dhe rasti tjetër, sipas tij, ai i presidentit Hashim Thaçi i cili po shprehë gatishmëri

për të negociuar me Serbinë çështjen e kufirit të Kosovës. Sipas Hotit, këto çështje e bëjnë urgjente mocionin dhe formimin e institucioneve të reja legjitime që mund të flasin në emër të qytetarëve.

"Për momentin, tri grupet parlamentare opozitare i kanë 58 vota. Duhet edhe 3 vota shtesë për të ta kaluar mocioni i votëbesimit. Ne

do të provojmë të dakordohemi edhe me grupe tjera parlamentare duke parë që edhe ata që nuk mund të funksionojnë në këtë mënyrë. Një gjë është e qartë që Kuvendi i Kosovës, institucionet nuk mund të funksionojnë normalisht sepse nuk ka shumicë parlamentare", tha Hoti. Ndërkaq, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, tha për Radion

Evropa e Lirë se aktualisht roli i opozitës nuk është i mjaftueshëm numerikisht për ta kërkuar një mocion mosbesimi.

"Numrat e opozitës tash për tash nuk janë të mjaftueshëm për ta kërkuar mocionin ndaj qeverisë dhe kjo është e kuptueshme, sepse nuk i kemi numrat e mjaftueshëm. Procedura e dini se si është, duhet t'i kemi 61, të cilët votojnë për rrëzimin që të kërkojmë një gjë të tillë dhe ne nuk i kemi ata numra. I thërras deputetët e shumicës që për një moment të jenë të vetëdijshëm që ata para se gjithash i takojnë Kosovës e pastaj partive politike. E në këtë rast do të duhej që rolin e tyre ta fusnin në shërbim të Kosovës para se tu shërbëjnë partive të veta", tha Selimi. Ai thotë se deputetët e Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të qytetarëve dhe interesave të vendit do të duhej të ishin në nivelin më të lartë të përgjegjësisë dhe të reflektionin në këtë situatë në të cilën është futur Kosova. Ai tha se pikërisht ata deputetët të atyre partive politike që kanë votuar qeverinë aktuale dhe presidentin, do të duhej të reflektionin sa më parë për të ndryshuar gjendjen. Koalicioni aktual qeverisës vazhdon të ballafaqohet me faktin e humbjes së shumicës në Kuvend, pasi Lista Serbe ka kaluar tashmë në opozitë. Bazuar në gjendjen aktuale, Qeveria nuk e ka shumicën, por as opozita nuk i ka 61 votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë.

## Lëvizja e kufijve apo e njerëzve nënkupton shpërthim

Drejtori i Iniciativës për Stabilitet Evropian, Gerald Knaus, ka thënë se ideja për ndryshim të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë është metodë për konflikte të reja. Këto, Knaus i ka thënë në një intervistë për mediumin boshnjak, "Dnevni Avaz". "Ideja se problemet e pakicave zgjidhen më së miri duke i hequr pakicat - duke zhvendosur kufij apo njerëz - gjithmonë ka qenë shpërthyes. Është një metodë për të krijuar konflikte të reja, dhe në Ballkan për të kthyer kohën prapa në të '80-at, kur në vend se të diskutoheshin reformat, intelektualët dhe politikanët në ish-Jugosllavi u përqendruan në kufij dhe në çështjet etnike. E dimë se si përfundoi ajo. Kushdo me një kujtesë të historisë, apo me logjikë të qartë, do ta kundërshtonte këtë", ka thënë Knaus. Ai thotë se aktualisht, askush s'po e di se për kush për çka po flet në kontekstin e kufijve të Kosovës dhe Serbisë, ndërsa thekson se Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk ka mandat nga parlamenti për të diskutuar as edhe një gjë të vetme në këtë moment. "Ai thotë se kjo ka të bëjë me 'korrigjim kufijsh'. Në rregull, ka pasur korrigjime kufijsh edhe më parë, por të gjithë e dinë se kjo nuk është ajo që po e dëshiron Beogradi: disa shkëmbinj apo pyje të pabanuara në Kosovën veriore. Kjo ka të bëjë me njerëzit e vërtetë, të cilët veçse kanë përjetuar kohë traumatike, në Kosovë dhe në Serbi dhe në tërë rajonin. Ajo që shohim në janë dy presidentë që diskutojnë pa transparencë për kokat e këtyre njerëzve se ku duhet të jetojnë ata. Për të diskutuar të ardhmen e dhjetëra mijëra njerëz prapa dyerve të mbyllura është një gjë që e kanë bërë diplomatët evropianë në Kongresin e Berlinit në shekullin e 19-të. E dimë si përfundoi: shumë më shumë luftëra në Ballkan, për 100 vjet tjera, dhe shumë miliona tjerë të zhvendosur", shtoi Knaus.

## Thaçi në Kuvend të sqarojë idenë e "korrigjimit" të kufijve

Nisma e opozitës që para datës 7 shtator, të zhvillohet një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit në lidhje me dialogun që Kosova po zhvillon me Serbinë, po mbështetet nga një pjesë e shoqërisë civile, e cila përcjell nga afër punën e institucioneve

Përfaqësuesit e shoqërisë civile i bëjnë thirrje Kuvendit të Kosovës që të trajtojë çështjen e negociatave me Serbinë dhe sidomos paralajmërimet për korrigjimin e kufirit. Rrjedhimisht, Kuvendit i kërkohet të ketë një rol më aktiv në procesin final të negociatave me Serbinë që pritet të zhvillohet nëpër raunde të caktuara në Bruksel, me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Sipas tyre, Kuvendi duhet të hartojë platformën për dialog dhe të autorizojë ekipin negociator, duke e mbajtur atë përgjegjës për procesin.

Albert Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës tha për Radion Evropa e Lirë, se ky institut e mbështetë nisimën e ndërmarrë nga opozita për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për dialogun Kosovë-Serbi. Ai tha se si KDI fton të gjitha partitë politike parlamentare të mobilizohen për të mbledhë nënshkrimet e nevojshme për të thirrur sa më shpejt këtë seancë. "Së fundi kemi bërë një thirrje drejtuar Kuvendit që të ketë një seancë të jashtë-

zakonshme, për shkak se pamë që një gjë e tillë nuk është në agjendën e Kuvendit dhe nuk po flitet për një çështje të tillë që partitë parlamentare të nxjerrin një rezolutë, e cila do të shërbente si platformë për dialog, dhe tani kur presidenti Thaçi i cili në kokë në vete është duke zhvilluar gjithë këtë proces të dialogut dhe flet për shkëmbim të territoreve. Tash më shumë se asnjëherë më parë, Kuvendi duhet ta thërrasë këtë seancë të jashtëzakonshme dhe të ndalojë këtë praktikë të presidentit, e cila në thelb është kundërkushtuese që të bëjë dialog me një shtet tjetër për kufij", tha Krasniqi. Edhe drejtoresha e organizatës 'Fol', Mexhide Demolli-Nimani, tha për Radion Evropa e Lirë, se ideja e fundit e presidentit Thaçi, por edhe i gjithë procesi i bisedimeve politike mes Kosovës dhe Serbisë, duhet të jetë më transparent si për qytetarët, po ashtu edhe për Kuvendin dhe mekanizmat e tjerë shtetërorë. Ajo thotë se tashmë për fazën e fundit të dialogut, Kosova do të duhej ta kishte platformën e vet.



"Mendoj se edhe shoqëria civile mund të bëjë më shumë në këtë drejtim, sepse në njëfarë mënyre ky është edhe roli i saj që të informojë qytetarët rreth asaj që po ndodhë në gjithë këtë proces. Deputetët, çka është pak për t'u habitur, ata nuk po i ndërpresin pushimet e tyre dhe të thërrasin seancë dhe të kërkojnë llogari në Kuvend, aty ku edhe dihet të kërkohej llogaria nga presidenti për idenë e tij për korrigjimin e kufirit. Prandaj, unë mendoj se deputetët pa dallim partie, do të duhej të ishin më aktivë në këtë proces dhe të kërkohej llogari", tha Demolli-Nimani. Subjekti më i madh opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës ka ndërmarrë tashmë nisimën për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme para datës 7 shtator, kur pritet të mbahet takimi i radhës ndërmjet presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandar Vučić në Bruksel. Kjo nisimë, është thënë se e ka edhe mbështetjen nga Lëvizja Vetëvendosje dhe nga Partia Socialdemokrate.





# KISHAT PO ZBRAZEN

Numri i gjermanëve që janë anëtarë në kishën evangjeliste dhe atë katolike u pakësua edhe në vitin 2017. Krahas ndryshimit demografik, ekspertët shohin këtu edhe shkaqe të tjera

Kisha katolike dhe ajo evangjeliste, dy kishat e mëdha në Gjermani publikuan shifrat për anëtarët e tyre në vitin 2017. Numri i katolikëve në Gjermani ka rënë nga 23.6 milionë në vitin 2016 në 23.3 milionë në vitin 2017. Numri i protestantëve ra nga rreth 21.9 milionë në 2016 në rreth 21.5 milionë në 2017. Shifrat më të fundit janë pjesë e një tendencë që ka kohë që është përvijuar, e cila ecën që prej ribashkimit të Gjermanisë në të njëjtin drejtim: për poshtë. Shkaku kryesor për rënien e numrit të anëtarëve është ndryshimi demografik dhe plakja e anëtarëve. Në kishën evangjeliste vitin e kaluar vdiqën 390.000 anëtarë, por u pranuan

me anë të pagëzimit vetëm 180.000 anëtarë të tjerë. Një shkak për strukturën moshore konsiston në vështirësinë për t'i tërhequr të rinjtë. "Shumë të rinj thuajse nuk vijnë fare në kontakt me jetën kishtare, sepse nuk socializohen dhe edukohen në mënyrë të krishterë", thotë Olaf Müller, bashkëpunëtor shkencor në grupin e ekselencës Feja dhe Politika në Universitetin e Mynsterit. "Kjo bën që më vonë të mos e gjejnë më rrugën e kishave".

## RITUALETË HUAJA

Gati gjysma e gjermanëve, më pak se 43 për qind, sipas statistikave kishtare e përcakton veten si ateistë ose deklaror një konfesion tjetër, jo katolik ose evangjelist. Edhe daljet nga kisha janë një problem për të dyja konfesionet. "Numri i atyre që dalin nga kisha të dhemb", i komenton Sekretari i Konferencës Gjermane të Ispeshkve, Hans Langendörfer shifrat më të fundit për anëtarët, që u publikuan të premtën. "Ne duam të kuptojmë se pse njerëzit nuk gjejnë në kishë një vend për orientim për jetën dhe për besimin e tyre". Shpjegimi i ekspertit për kishat, Olaf Müller është që shumica e njerëzve, që dalin me ndërjegje nga kisha, nuk janë të

pakënaqur konkretisht me kishën e tyre ose me priftin. Studimet kanë nxjerrë në pah se për shumë veta, ritualet kishtare dhe doktrina thjesht nuk kanë asnjë kuptim.

## POLONIA SI KUNDËRSHIBULL

Një pikë e tretë janë zhvillimet shoqërore, që vërehen edhe në vende të tjera perëndimore. "Këtu bën pjesë individualizimi dhe mirëqenia në rritje, që ecën hap pas hapi me rrethanën se njerëzit nuk kanë më nevojë për fenë", shpjegon Müller. Veç kësaj, njerëzit kanë sot mundësi më të mëdha për ta organizuar kohën e lirë se sa disa breza më parë.

Shërbimi kishtar nuk është më e vetmja formë për të gjetur shokë. Por ka edhe përjashtime, që e kundërshtojnë tendencën. "Atje, kur feja dhe kisha kanë formësuar identitetin kombëtar ka edhe më shumë vetë anëtarë të kishës", deklaroi Müller dhe përmend si shembull Poloninë. Nga ana tjetër, njerëzit në Gjermani i vlerësojnë kishat para së gjithash si aktorë në sferën sociale. Kisha evangjeliste thotë për shembull se nga viti 2011 deri 2017 numri i kopshteve ditore për fëmijët është rritur nga 8495 në 8800.



## Trump fillon luftë edhe me Google

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në vazhdim të sulmeve të tij me mediat dhe kompani mediale, për siç thotë ai përhapjen e "lajmeve të rreme" tash ka nisur edhe një luftë të hapur me kompaninë e njohur gjigante, Google. Kjo sipas Trumpit po gjeneron vetëm të dhëna që përmbajnë lajme të rreme në lidhje me të. Përmes një postimi në Twitter, shefi i Shtëpisë së Bardhë thekson se rezultati i kërkimit me fjalët "Trump News" tregojnë vetëm njoftime të mediave që, sipas pikëpamjes së tij, përhapin lajme të rreme. Në këtë mënyrë, shpjegon ai, thuajse të gjitha ngjarjet dhe njoftimet janë të këqija. "CNN spikat mbi të gjitha! Republikanët/konservatorët dhe mediat e paanshme janë të përjashtuara. I paligjshëm?", ka shkruar Trump.



## Fëmijët e Gazës po vuajnë për pak qumësht

Ministria e Shëndetësisë e udhëhequr nga Hamasi në Gaza tha se mungesa e qumështit terapeutik në spitalet lokale është duke kërcënuar shëndetin e fëmijëve që vuajnë nga një çrregullim gjenetik. "Mungesa e qumështit terapeutik për fëmijët me PKU (Fenilketonuria), të shkaktuara nga anomalitë gjenetike në metabolizmin e tyre, i bën këta fëmijë të rrezikuar nga retardimi mendor", tha ministria në një deklaratë. Ministria vuri në dukje se kjo gjendje çon në komplikime të këta fëmijë, duke filluar të zvogëlojë gradualisht IQ-në e tyre, derisa ata të bëhen me aftësi të kufizuara mendore. Ajo theksoi se qumështi terapeutik për 22 fëmijë të sëmurë nën moshën 12 muajshe nuk është "në dispozicion" në dyqane ose spitale, ndërsa qumështi për pacientët mbi moshën njëvjeçare është në dispozicion në sasi të vogla të mjaftueshme vetëm për tri javë. Bllokada 11-vjeçare e Izraelit në Rripin e Gazës ka dëmtuar ekonominë e enklavës bregdetare dhe ka privuar dy milionë banorët e saj nga shumë mallrave elementare, duke përfshirë medikamentet dhe pajisjet mjekësore.

## "Drejtësi për Vanesën", prostitutën që mbrojt klientin

Pesë persona janë akuzuar nga policia franceze në Paris për vrasjen e një prostitute transgjimore peruane, e cila u qëllua për vdekje pasi u përpoq të mbronte klientin e saj. Vanesa Campos 36 vjeç u vra mesnatën e 16-17 gushtit në një park, që njihet si zona e prostitutave.

Vrasja e 36-vjeçares ndezi një valë zemërimi të prostitutave dhe aktivistëve të LGBT. Qindra vetë

marshuan në Paris duke kërkuar mbrojtje më të madhe dhe siguri për prostitutat. Ato mbanin në duar pankarta ku shkruhej "Drejtësi për Vanesën", por gjithashtu akuzuan shtetin francez si "pjesëmarrës" në vrasjen e një gruaje transgjimore.

"Ligji është 100% përgjegjës për vrasjen e Vanesës", thanë protestuesit. Prostitutat kërkojnë shfuqizimin e një ligji të vitit 2016,

që e kategorizon veprën penale prostitucionin. Për këtë arsye, prostitutat në Francë thonë se janë të detyruara të punojnë në vende të izoluar për të shmangur policinë.

Sipas mediave franceze, Vanesa punonte si prostitutë prej dy vitesh. Ajo ishte me një klient kur 10 burra të pajisur me pistoletë, thika e shkopinj tentuan të grabisnin makinën e tij. Vanesa u për-



poq të mbronte klientin e saj, por u vra me një plumb në gjoks. Nuk dihet nëse klienti u lëndua apo

jo. Javën e kaluar, policia franceze arrestoi 8 persona dhe 5 janë akuzuar për vrasje dhe grabitje.



Perëndimi, dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara, mund të kishin lehtësuar tranzicionin e Bashkimit Sovjetik. Ndërsa Ronald Regan dhe Mikhail Gorbaçov krijuan një partneritet të frytshëm, pasardhësi i Reganit, Xhorxh HW Bush, ishte i tepër i ngadalshëm për të vepruar, kur reagimi i konservatorëve e vuri Gorbaçovin në pozita të pambrojtura. Siç thotë Taubman, Gorbaçovi donte diçka të ngjashme si Plani Marshall, dhe Bush nuk pranoi t'ia jepte atë

Nga Barbara MARANXANI

Vetëm 6 vjet pasi Mikhail Gorbaçov u ngjit në pushtet si Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste dhe filloi zbatimin e disa reformave, Bashkimi Sovjetik u shemb dhe u formuan shumë kombe të pavarura. Po çfarë shkoi gabim? Në vitin 1985, edhe shumë prej përfaqësuesve të linjës së ashpër, e kishin kuptuar se duhej një ndryshim i thellë. Ekonomia sovjetike ishte e sëmurë, dhe disidentët dhe kritikët e brendshëm dhe të jashtëm, po bënin thirrje t'i jepej fund shtypjes politike dhe sekreteve qeveritare. Menjëherë pas marrjes së pushtetit, Gorbaçovi u përpoq t'i përballonte këto sfida. Nën një politikë të re të glasnostit ose transparencës dhe hapjes, liritë e reja të shtypit hodhën dritë mbi shumë nga aspektet më negative të Bashkimit Sovjetik, si të kaluarën ashtu edhe të tashmen. Dhe me Perestrojkën, Bashkimi Sovjetik do t'i nënshtrohej një ristrukturimi të shpejtë politik dhe ekonomik, që synonte të transformonte shumëçka nga shoqëria sovjetike. Ndërsa reformat e glasnostit dhe Perestrojkës, nuk ishin shkaqet e vetme të shpërbërjes së BRSS, forcat që ato çliruan, destabilizuan një sistem tashmë të dobësuar, dhe nxitën fundin e tij.

Reformat ekonomike nën Perestrojkën - duke përfshirë ligjet që lejuan krijimin e ndërmarrjeve bashkëpunuese, penguan kufizimet në tregtinë e jashtme, dhe zbutën kontrollin e centralizuar në shumë prej tyre - synonin t'i jepnin një nxitje të re ekonomisë vendase. Por kjo nuk ndodhi.

Përkundrazi, shpenzimet qeveritare u rritën (duke çuar në një deficit të madh), çmimet u rritën sidomos ato të ushqimeve, pasi sektori i mëparshëm bujqësor i subvencionuar, prodhonte tani ushqim për fitime, dhe jo me çmimet e kontrolluara si dikur. Transformimi mbresëlënës politik, i cili pa zhvillimin e zgjedhjeve të para të vërteta demokratike në histo-

# KUR PERESTROJKA SHEMBI BASHKIMIN SOVJETIK!



rinë sovjetike më 1989-ën, dhe krijimin e një Kongresi të ri të Deputetëve të Popullit, pati ndërkohë edhe pasoja të paqëllimshme.

Me fuqizimin e decentralizimit, nga burokracia masive komuniste drejt kontrollit nga pushteti lokal, Gorbaçovi distancoi aparatçikët e partisë, e privoi veten nga një bazë fuqie për të mbështetur reformat e tij, nxiti lëvizjet nacionaliste dhe të pavarësisë brenda dhe jashtë BRSS, dhe "plagosi" për vdekje vetë Partinë Komuniste. Edhe pse e pranonin nevojën për reforma, përfaqësues të linjës së ashpër u ngritën shpejt kundër shumicës së këtyre ndryshimeve, të cilat dobësonin pozicionet e tyre të fuqishme dhe i shmangeshin ortodoksisë komuniste. Ata shfrytëzuan liritë e reja të shtypit nën Glasnostin, për të sulmuar në media Gorbaçovin.

Më 19 gusht 1991, një grupim



prej tyre organizoi një grusht shteti për të rrëzuar Gorbaçovin. Grupi i shtetit dështoi, por ai e destabilizoi më tej sistemin sovjetik. Ndërkohë, disidentët e sapoliruar nga burgju, si fizikanti dhe laurea-

ti i Nobelit Andrei Saharov, kritikuan ritmin dhe shtrirjen e reformave, duke nxitur një lëvizje të plotë drejt ekonomisë së tregut dhe liberalizimit të mëtejshëm të procesit politik, lëvizje që Gorbaço-

vi shpesh nuk donte t'i bënte. Vetë populli sovjetik, ishte i papërgatitur për shpejtësinë e reformave. Ndërsa u deshën disa vite që reformat ekonomike dhe politike të Perestrojkës të nisnin të zbatoheshin, transparenca e re nën Glasnostin ndodhi menjëherë. Pati zbulime tronditëse, në lidhje me abuzimet e ndodhura në të kaluarën nën sistemin sovjetik.

Uilliam Taubman, historian dhe autor i librit "Gorbaçov: Jeta dhe koha e tij", që ndodhej në Moskë në atë kohë, kujton: "Ne ngriheshim herët çdo mëngjes, për të blerë çdo gazetë apo revistë që mundnim. Dhe kur mbërrim tek stenda në orën 6.30 ose 7, rraha ishte tepër e gjatë... Moska ishte shndërruar në një klasë gjigande, në të cilën të gjithë po lexonin!". Dhe teksa epoka staliniste ishte në fokusin e hershëm të këtyre zbulimeve, transparenca preku shpejt edhe tema që dikur ishin tabu. "Në fillim, Lenini nuk u prek, por shumë shpejt dëshmitë tronditëse, denonconin të gjithë sistemin sovjetik", thotë Taubman. Kjo përfshinte ekspozimin e korrupsionit dhe joefikasitetit, në sistemin modern të Bashkimit Sovjetik. Shpejtësia me të cilën themelet e komunizmit sovjetik, po viheshin nën akuza të ashpra, ishte shumë shqetësuese për shumëkënd në Bashkimin Sovjetik, duke destabilizuar më tej një situatë tashmë të pasigurt.

Gorbaçovi, u përpoq të mbante nën kontroll forcat që kishte çliruar. Duke u rritur në radhët e Partisë Komuniste, ai ishte një luftëtar i aftë që mund t'ia dilte përballë aparatikëve të Kremlinit. Por, kur u përball me një grup të rinjsh të zgjedhur në mënyrë demokratike, ato aftësi nuk i vlejten aspak. Një tjetër udhëheqës në rritje, Boris Jelcin, ishte i njohur për popullaritetin. Marrëdhënia gjithnjë e më e tensionuar midis dy burrave, u dëshmuar të ishte katastrofale. Siç thotë Taubman: "Ishte një konflikt i frikshëm shekspirian. Ata duhet të kishin qenë aleatë, mund të kishin qenë aleatë të mrekullueshëm me aftësitë e tyre të ndryshme, por u kthyen në armiq për njëri-tjetrin. Gorbaçovi luajti një rol në krijimin e Jelcinit si nga armiqët e tij, dhe më pas Jelcini i nguli thikën në shpinë".

A do të shkatërrohej Bashkimi Sovjetik pa Gorbaçovin dhe reformat e tij? S'ka dyshim se këto reforma, që synonin forcimin e ekonomisë dhe transformimin e sistemit







Me fuqizimin e decentralizimit, nga burokracia masive komuniste drejt kontrollit nga pushteti lokal, Gorbaçovi distancoi aparatçikët e partisë, e privoi veten nga një bazë fuqie për të mbështetur reformat e tij, nxiti lëvizjet nacionaliste dhe të pavarësisë brenda dhe jashtë BRSS, dhe "plagosi" për vdekje vetë Partinë Komuniste

politik, dëmtuan në fakt vetë themelet e Bashkimit Sovjetik. Ka të ngjarë, thotë Taubman, që Bashkimi Sovjetik të mundej të mbijetonte edhe për një numër vitesh, por do të ishte bërë shumë më i dobët. Ndërsa një lloj kolapsi mund të ketë qenë i pashmangshëm, Taubman beson se, falë Gorbaçovit, fundi ishte shumë më pak i trazuar sesa mund të ishte ndryshe. "BRSS mund të merrete fund me një luftë civile, si modeli jugosllav, kur federata u shpërbë, dhe rajonet apo republikat filluan të luftonin kundër njëra-tjetrës. Gorbaçovi është përgjegjës për fundin relativisht paqësor të një perandorie".

Perëndimi, dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara, mund të kishin lehtësuar tranzicionin e Bashkimit Sovjetik. Ndërsa Ronald Regan dhe Mikhail Gorbaçov krijuan një partneritet të frytshëm, pasardhësi i Reganit, Xhorxh HW Bush, ishte i tepër i ngadalshëm për të vepruar, kur reagimi i konservatorëve e vuri Gorbaçovin në pozita të pambrojtura. Siç thotë Taubman, Gorbaçovi donte diçka të ngjashme si Plani Marshall, dhe Bush nuk pranoi t'ia jepte atë. "Bush mund të ketë qenë i shqetësuar se ndihma do të fironte. Por në fund, kur Gorbaçovi kishte nevojë për ndihmë ekonomike në mënyrë të dëshpëruar, Bush nuk do t'ia siguronte atë". Ky vendim pati pasojë që vazhdojnë sot. Taubman beson se kjo periudhë shënoi të vetmen periudhë në shekullin e fundit, që Amerika kishte një partner rus apo sovjetik, që ishte vërtet i gatshëm të ishte një aleat, duke e bërë atë një mundësi të humbur të përmahësive të mëdha. Sot presidenti Vladimir Putin, fajëson Gorbaçovin për kolapsin që pësoi kombi i tij. (bota.al)

Robotët mund të vendosin për jetë apo vdekje në luftën e së ardhmes pa dorën e njeriut. Zhvillimi i armëve autonome po ecën me temp të shpejtë. Në Gjenevë po diskutohet sërish për ndalimin e tyre

Me një zukamë të fortë minidronet vijnë vërdallë në sallën e leksioneve dhe bien mbi studentët që i godasin në ballë. Kjo skenë shihet në një film të përgatitur nga kundërshtarët e armëve autonome në një videoportal të You Tube-t. Dronet më të vogla se një pjatë i identifikojnë viktimat e tyre me anë të algoritmeve. Nëse e kanë fiksuar objektivin nuk ka më shpëtim. Të dhënat këto minidrone të lidhura në disa rrjete i marrin nga rrjetet sociale. Ato vrasin vetëm ata njerëz që kanë shpërndarë një video kritike – ky është subjekti i historisë.

#### GJITHÇKA SCIENCE-FICTION?

Titulli i filmit me metrazh të shkurtër "Slaughterbots" është klikuar më shumë se dy milionë e gjysmë herë nga publikimi i tij në nëntor 2017. Gjithçka vetëm science fiction, halucinacione të njerëzve të frikësuar? Në asnjë rast, mendon Thomas Küchenmeister, që angazhohet për ndalimin e sistemeve të armëve autonome. "Hapi deri aty është shumë i vogël". Küchenmeister është kryetar i "Facing Finance", një organizate gjermane, pjesëtare e fushatës ndërkombëtare "Stop Killer Robots". Ai viziton panaire të armëve dhe bisedon me prodhuesit e tyre. Armë me një autonomi të caktuar ka edhe sot, për shembull raketat që kërkojnë në mënyrë të pavarur objektivat e mundshme dhe vendosin vetë, se cilin mund të shkatërrojnë. Kryesisht ato komandohen nga njerëzit, por për sulmin konkret nuk ka ushtarë që jep urdhrin, shpesh ai as nuk mund ta ndalë raketën.

#### NË KONFLIKT ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Sipas Küchenmeister kjo është "tejet problematike". "Një armë e tillë nuk mund të bëjë dallimin mes një automjeti ushtarak apo civil." Por pikërisht këtë e kërkon e drejta ndërkombëtare, një nga rregullat bazë të së drejtës ndërkombëtare të vlefshme në kohë lufte. Ajo i detyron palët në konflikt për mbrojtjen sa më të mirë të civilëve dhe ndërtesave civile. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq i përcakton armët autonome si armë që e kërkojnë vetë, e zgjedhin dhe sulmojnë apo shkatërrojnë vetë një objektiv të caktuar. Pikërisht këtu është problemi, thotë Küchenmeister. Çfarë ndodh, nëse në përzgjedhjen e pavarur kjo armë shkatërron jo vetëm armët kundërshtarë por vret edhe civilët? "Ne nuk mund t'i injektujmë këtyre armëve chip-a me të drejtën ndërkombëtare", thotë eksperti.

#### INTELIJENCA ARTIFICIALE NË INDUSTRIJËN E ARMËVE

Rritja e ndjeshme e shkallës së autonomisë të sistemeve të armatimit ka të bëjë me progresin e shpejtë të inteligjencës artificiale. Ndërkohë makineritë janë të afta të mësojnë dhe përpunojnë përvojat përmes rrjeteve neuronale artificiale si truri njerëzor. Industria e armëve e përdor këtë: Armët bëhen më eficiente, më të shpejta, në një kohë që rreziku për ushtarët ulet. Kjo është pikërisht ajo çfarë kërkojnë ushtritë. Por kufijtë janë të lëvizshëm: Edhe nëse një robot që kërkon në mënyrë të pavarur minat është i pranueshëm, ai robot që kërkon pa kontroll njerëzit, i iden-

# TË NDALEN ROBOTËT VRASËS!



tifikon dhe qëllon mbi ta është një rast për të drejtën ndërkombëtare. Por si mund të zbatohet e drejta ndërkombëtare për armë të tilla? Për këtë debatohet në Gjenevë në konferencën për armët autonome mbi bazën e "Konventës Ndërkombëtare të Armëve Konventionale", ku marrin pjesë më shumë se 70 vende, organizata joqeveritare dhe ekspertë. Fillimisht kur këto bisedime filluan në vitin 2017 ishin informale, por nga viti i kaluar ato janë kthyer në negociata zyrtare. Objekti i diskutimit të konferencës në Gjenevë nga 27-31 gusht janë sistemet vdekjeprurëse të armëve autonome. Bashkësia ndërkombëtare është e ndarë në përkrahës që janë kundër ndalimit të armëve autonome, kundërshtarë të tyre, si edhe vende si Gjermania e Franca që duan të ndjekin një rrugë të mesme.

#### "AI SUNDON BOTËN"

Kundër ndalimit të armëve të tilla argumentojnë vende që investojnë shuma të mëdha për përdorimin ushtarak të inteligjencës artificiale, si SHBA, Izraeli, Rusia dhe Britania e Madhe. Presidenti rus, Vladimir Putin para nxënësve në shtator 2017 u shpreh, se kush është lider në inteligjencën artificiale ai sundon botën. Qeveria amerikane madje i paraqet këto armë në një afond pozitiv. Delegacioni amerikan në takimin e fundit për këtë temë në Gjenevë u shpreh se armë të tilla ndikojnë në më pak viktime civile dhe "dëme kolaterale". Nëse një ushtar turbullohet nga tërësia e informacioneve në një fushë luftimi, kompjuteri mbetet i fokusuar dhe bën më pak gabime. Amerikanët

kërkojnë mosstigmatizimin e sistemeve të armëve autonome.

#### NDALIMI I ARMËVE AUTONOME

Vetëm 26 vende kërkojnë ndalimin me detyrim të përdorimit të armëve autonome dhe mirëpritën për këtë nga shoqëria civile. Më shumë se 230 organizata dhe 3000 persona civilë kanë nënshkruar një peticion kundër armëve të tilla. Mes tyre edhe kreu i Teslas, dhe lider në fushën e inteligjencës artificiale, Elon Musk. Vendimi për të eliminuar një njeri nuk duhet t'i lihet asnjëherë asnjë kompjuteri. Gjermania aktualisht nuk e mbështet përhapjen e armëve të tilla. Por të kërkojë direkt ndalimin e tyre, për diplomatët gjermanë është e gabuar, frontet janë shumë ndara. Bashkë me Francën ajo ndjek një rrugë të mesme. Si hap të parë qeveria gjermane kërkon një deklaratë politike, e cila më vonë duhet të mbështetet nga një kod sjelljeje ushtarake dhe në hapin e fundit një marrëveshje ndalimi. Në këtë qëndrim disa hapësh, diplomatët gjermanë shohin një shans për kalimin e diferencave të mëdha.

Koha nuk pret. Diplomatët dhe aktivistët janë të një mendimi. Edhe informaticieni i njohur amerikan, Stuart Russell, i cili hulumton në këtë fushë prej 35 vitesh dhe kishte idenë për filmin "Slaughterbots", thote se ende mund të pengohet një skenar i tillë, "por dritarja e kohës po mbyllet shpejt." Nëse bisedimet e këtyre ditëve në Gjenevë, nuk sjellin sukses, atëherë do të rritet presioni i shoqërisë civile, paralajmëron eksperti Küchenmeister. (Deutsche Welle)





Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtorë nr. 04-988/1 të datës 17.08.2018, nenit 23 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec, Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes, publikon

#### SHPALLJE

##### Për pranimit të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranimit të punëtorëve për kohë të caktuar prej 6 (gjashtë) muajve edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. "Larës" në departamentin për higjienë (shërbyese) publike, Sektori Higjiena Komunale, 2 (dy) realizues, shifra e vendit të punës KDR 0305V02 014, me neto pagesë fillestare prej 13.850,00 denarë.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Është e nevojshme që kandidatët të kenë së paku nivelin e kualifikimeve të shkallës I të arsimit ose arsim fillor.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor në tri gazeta ditore prej të cilave një në gazetën që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet duhet t'i parashtrajnë në adresën:

NP Komunalec Kavadar, rr. "Industriska" pn, Kavadar, personalisht në arkiv ose përmes postës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

NP Komunalec Kavadar  
Drejtor  
Gjorgji Pop Icov

#### KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS

##### Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës

Në bazë të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12, 55/13, 199/14, 44/15, 193/15 dhe 35/16), dhe nenit 3 të Rregullores për pjesëmarrje të opinionit gjatë përpilimit të dispozitave dhe akteve të tjera, si dhe planeve dhe programeve nga sfera e mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 147/08 dhe 45/11), Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës, publikon

#### LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçer Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

1. Prezantim publik dhe anketë publike në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim B5 – kompleks hotelierik në PK 2964/2, KK Glluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës.

Prezantimi publik i DLPU do të mbahet më datë 05.09.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 10:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçer Sandevës

Anketa publike për DLPU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Sipërfaqja për të cilën organizohet anketë publike dhe prezantim publik për Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim B5 – kompleks hotelierik në PK 2964/2, KK Glluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës gjendet në pjesën juglindore të KK Glluvo Brazda dhe në mënyrë administrative bie nën Komunën e Çuçer Sandevës, madhësia e sipërfaqes është 3500 m<sup>2</sup>.

Dokumentet planore do të ekspozohen në lokalet e Komunës së Çuçer Sandevës në f. Kuçevishte. Qytetarët dhe subjektet juridike të përfshirë në afatin e paraparë mund të parashtrajnë vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 15:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS  
KRYETARI I KOMUNËS  
Jovan Pejkovski

I nr. 088/2018

#### SHPALLJE PUBLIKE

(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 të LP të Publikuar në Gazetën Zyrtare të RM nr. 72 të datës 12.04.2016)

Përmbarusi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Shoqëria për shërbime intelektuale dhe tregti, të bazuar në dokumentin përmbarus NPN nr. 312/2017 të Noterit Bashkim Elezi nga Gostivari, kundër Shoqërisë për punësim të personave invalidor ndërtimtar tregti dhe shërbime XHIMI KO SHPKNJ eksport-import Gostivar, për lëndën përbaruese të nën I nr. 088/2018 më datë 23.08.2018

#### FTON

- Zafirovska Gjurgjena me adresë në Kozle 174, Shkup,
  - Zafirovski Qiro Зафировски Киро me adresë në Kozle 174, Shkup,
  - Ilkovski Mario rr. Dramska nr. 8, Shkup,
  - Irena Gjorgjevska me adresë Hristo Tatarçev 7/5, Shkup,
  - Kosta Tupuzoski me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4, Shkup,
  - Kostadina Çallmoska Popovska me adresë Kole Nedelkovski 15 A, Shkup-Çair,
  - Mirjana Topuzoska me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4, Shkup,
  - Sava Sasho me adresë Predrag Jançevski 36, Tetovë,
  - Sevinc Ali Osman R. Gjermanisë,
  - Tomiq Tomislav bul. Partizanski Odredi 153/1/60, Shkup,
  - SHOQËRIA TREGTARE PËR NDËRTIMTARI, TREGTI DHE SHËRBIME EUROPROFIL SHPKNJ EKSPORT-IMPORT me adresë Nikolla Vapcarov 2/1/1, Shkup
  - Tugiarova Gjorgjova Smila bul. Jane Sandanski 35/1/10, Shkup,
- të vijnë në zyrën e Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në rr. "Zivko Brajkovski" nr. 23" për shkak të dorëzimit të:
- Konkluzionit për shitje të dytë publike me gojë nga data 22.08.2018 I nr. 088/2018 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari, në afat prej 2 (dy) ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit në gazetën ditore Nova Makedonija dhe Koha, për shkak të realizimit të së drejtës ligjore për blerje të drejtëpërdrejte.

PËRMBARUES  
Aleksandar Kuzmanovski

#### INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL PËR FËMIJË – ÇERDHJA PËR FËMIJË

##### "DIMÇE MIRÇEV" – VELES PUBLIKON

#### SHPALLJE

##### PËR PRANIM TË PUNËTORËVE PËR KOHË TË PACAKTUAR

1. IPKÇF "Dimçe Mirçev" – Veles ka nevojë për punësim për orar të plotë të punës për kohë të PACAKTUAR me orar të plotë të punës të punëtorit në Komunën Çashka edhe atë:

- MIRËMBAJTËS TË HIGJENËS..... 1 (NJË) realizues;

2. Kushtet e nevojshme:

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

Për vendin e punës Mirëmbajtës të higjienës:

- arsim fillor të mbaruar ose arsim të mesëm; Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 05,30 - 13,30 ose prej ora 09,30 - 17,30, Neto pagesa fillestare...12.005,00 denarë.

Krahas kushteve të lartpërmendura, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim: Shtetas i RM, i shëndosh fizikisht dhe psikikisht, njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje-ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe të përmbushë kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.

3. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

4. Së bashku me fletëparaqitjen, të parashtrohet: diploma për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, licencë përkatëse valide në origjinal, certifikatë të shtetësisë, dëshmi për masë të pashqiptuar për siguri nga Regjistri qendror dhe dëshmi se nuk është i dënuar nga Gjykata themelore jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

5. Dokumentacioni i kompletuar me fletëparaqitjen të parashtrihen në adresën: IPKÇF "DIMÇE MIRÇEV" rr. Todor Hristov – Ificerçeto" nr. 1 në Veles, nr. i telefonit 043/231-226, personi për kontakt: Aco Petrushevski.

DREJTOR  
Branislava Naceva

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/41, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), nenit 110-g dhe 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 105/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16), pas Pëlqimit të marrë nga Ministria e financave nr. 18-9084/2 të datës 16.08.2018, dhe Vendimit të UD Drejtorit të IP Enti special Demir Kapia, publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE

##### Për punësim të:

1. 1 (një) realizues për kohë të pacaktuar për vendin e punës – motër kryesore medicinale  
Kandidatët të cilët do të konkurrojnë për vendin e punës, është e nevojshme të përmbushin Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

- Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës të motrës kryesore medicinale është puna me një ndërrim prej ora 06:30 deri në ora 14:30 ose 40 orë në javë

- neto pagesës fillestare për motër medicinale është: 16.937,00 denarë.

2. Kandidatët obligohen të parashtrajnë dëshmi përkatëse në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter, si për përmbushjen e kushteve të përgjithshme, ashtu edhe të parashtrajnë dëshmi për përmbushjen e kushteve të posaçme, edhe atë:

-Për motër kryesore medicinale për nivelin B1 së paku 60/120 kredi sipas SETK ose arsim të lartë të mbaruar, pa përvojje pune

- Diplome/Certifikatë/Dëftesa për shkallën e mbaruar të arsimit përkatës që kërkohet për vendin e punës – motër e lartë medicinale – drejtim i përgjithshëm;
- Shtetësi dhe
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës – jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e kërkua parashtrihen me zarf të mbyllur me shënim "Të mos hapet" në adresën në vijim:

IP Enti special Demir Kapia

Arkivi i Institucionit

(me shenjë "për shpallje")

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

IP Enti special Demir Kapia  
UD Drejtor  
Aleksandra Vellkovska

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtorë nr. 04-1009/1 të datës 27.08.2018 dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec, Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, Drejtori i ndërmarrjes, publikon

#### SHPALLJE

##### Për pranimit të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranimit të punëtorëve për kohë të caktuar prej 3 (tre) muajve edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. "Pastrues" në departamentin për tregjet, Sektori Shërbimet e përbashkëta, shifra e vendit të punës KDR 0305V02 013, me neto pagesë fillestare prej 13.850,00 denarë, 2 (dy) realizues.
2. "Punëtor për bartjen e bërllokut" në departamentin për higjienë (shërbyese) publike, Sektori për Higjienë Komunale, shifra e vendit të punës KDR 0305 V02 011, me neto pagesë fillestare prej 13.850,00 denarë, 1 (një) realizues

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Është e nevojshme që kandidatët të kenë së paku nivelin e kualifikimeve të shkallës I të arsimit ose arsim fillor.

Të gjithë kandidatët krahas lutjes për punë parashtrajnë edhe dëshmi për arsim të mbaruar

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor në tri gazeta ditore prej të cilave një në gazetën që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatët për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 45 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatët për një vend pune bëhet në afat prej 90 ditë dhe mbi 500 kandidatët për një vend pune bëhet në afat prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet duhet t'i parashtrajnë në adresën:

NP Komunalec Kavadar, rr. "Industriska" pn, Kavadar, personalisht në arkiv ose përmes postës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

NP Komunalec Kavadar  
Drejtor  
Gjorgji Pop Icov

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060  
marketing@koha.com.mk

#### URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221

#### URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m<sup>2</sup> me markë ndërtimore 430 m<sup>2</sup>, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, truall i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m<sup>2</sup>). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960



TALENTI I SHPRESAVE TË SHQIPËRISË NËNSHKRUAN ME KLUBIN E MADH KROAT

# HAJDUKU I SPLITIT ZYRTARIZON SAHITIN

Emir Sahiti është njëri ndër emrat më premtues të futbollit shqiptar. Ky i fundit nënshkroi kontratë 4 vjeçare me Hajdukun e Splitit pasi kaloi gjysmë sezoni në huazim nga Rabotnički

Klubi më me emër në Kroaci dhe Ballkan, Hajduku i Splitit, ka zyrtarizuar transferimin e Emir Sahitit nga Rabotnički i Shkupit. Emiri është vëllai i Suad Sahitit, ish lojtarit të Skënderbeut. Po ashtu talenti 19 vjeçar me prejardhje nga Kosova është sulmues i Shpresave të kombëtares shqiptare. Ish futbollist i Rabotniçkit e pëlqenin edhe shumë klube tjera por koha e kaluar si lojtar i huazuar te Hajduku bëri që klubi të veprojë shpejt. Sahiti ishte pjesë e ekipit të dytë të gjiganti kroat në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar. Tani sulmuesi është prezantuar në ekipin e



parë për sezonin 2018/19. Derisa ishte pjesë e ekipit të dytë futbollisti në fjalë zhvilloi 9 ndeshje duke shënuar vetëm një gol. Me një postim në rrjetin social Facebook, Sahiti shprehet tejet i lumtur dhe falënderon ish klubin e tij Rabotniçkin për korrektësinë e treguar.

"Falënderimi i takon Zotit, familjes time dhe menaxherëve të mi. Tani e tutje për 4 vite do të jem pjesë e klubit më të madh në Kroaci e po ashtu në Ballkan, HNK Hajduk Split. E falënderoj ish klubin tim Rabotniçkin për korrektësinë e treguar dhe për të gjitha vitet e kalua-

ra aty". Sahiti karrierën si futbollist e filloi në klubin KF Ramiz Sadiku në Kosovë. Më pas kaloi te FC Prishtina që më vonë të transferohet te Trepça 89. Talenti i tij u vërejt që në moshë të re kur Rabotnički e bleu dhe debutoi me ekipin e parë që në moshën 17 vjeçare.



## Maqedonia nuk llogarit në Ademin

Arijan Ademi lëndohet para fillimit të Ligës së Kombeve. Duke qartë se Maqedonia nuk do ta ketë të gatshëm mesfushorin e Dinamos se Zagrebit pasi që ky i fundit u lëndua që në pjesën e parë në duelin me Young Boys. Ka një kohë të gjatë që Ademi po lufton me lëndimet, ndërsa në fund vetëm që e lëndoi më shumë veten. Ditët në vazhdim do të kuptohet se sa do të qëndroj jashtë fushave Arijan Ademi, por shanset e për t'iu bashkuar Maqedonisë janë shumë të vogla. Të përzgjedhurit e seleksionuesit Angellovski më 6 shtator do të jenë mysafir të Gjibraltarit, ndërsa tri ditë më vonë në Shkup e presin Armeninë. Kjo do të jetë ndeshja kyçe për të luftuar për vendin e parë në grup.



## Angellovski flet për Ligën e Kombeve

Seleksionuesi i Reprezentacionit të Maqedonisë në futboll, Igor Angellovski, pas paraqitjes së lojtarëve të ftuar ka folur edhe për dy ndeshjet e para në kuadër të Ligës së Kombeve. Ndeshja me Gjibraltarin dhe Armeninë të cilat zhvillohen në shtator. Maqedonia gjendet në Grupin D ku do të përballlet me Armeninë, Gjibraltarin dhe Lihtenshtajnin. Angellovski foli para mediave duke thënë se "Unë edhe më herët kam thënë se do të thërras futbollist të ri nëse është nevoja. Ajo gjë ishte më se e duhur në mbrojtje. Tani i kam dy futbollist Egzon Bejtullain dhe Mite Cikarskin. Bejtullai po zhvillon ndeshje të rregullta te Shkëndija, ka qenë pjesë e të rinjve në reprezentacion dhe tani po merr pjesë në vend të Zajkovit. Presim edhe lajm nga Arijan Ademi i cili u lëndua. Të shohim se çfarë do të ndodhë me të, a do të jetë i gatshëm apo jo", u shpreh Angellovski.



## Mici optimist për ndeshjen e sotme

Pas fitores ndaj Bellasicës në kampionat vëmendja kryesore e Shkëndijës është te Rosenborgu. Sot (e enjte) "kuqezinjët" e Tetovës do të kenë një ndeshje historike në Shkup përballë klubit norvegjez. Pas përballjes me Bellasicën ku me një formacion të kombinuar arriti të korrë fitore bindëse 4:1, dëshiron që edhe në këtë duel të vazhdojë me këtë ritëm edhe pse do të jetë e vështirë. Ndeshja e Play Offit në kuadër të Evropa Ligës është jo edhe aq e lehtë për tetovarët pasi që në takimin e parë u ndalën me rezultat 3:1. Gledi Mici, njëri ndër lojtarët më të mirë të skuadrës ka folur për ndeshjen e sotme. "Futbolli është shumë i bukur dhe ndonjëherë i paparashikuar. Rosenborgu është një skuadër shumë e fortë por ne nuk i kemi humbur shpresat për të kaluar më tutje. Ne do të japim gjithçka nga vetja dhe shpresoj të kemi fat për të kaluar në fazën e grupeve". Me mbështetjen e tifozëve çdo gjë është e mundur në këtë duel të sotëm i cili do të zhvillohet në "Arena Filipi i Dytë" në Shkup me fillim nga ora 20:15.

## Cikalleshi ndërron klub në Turqi

Sokol Cikalleshi do të vazhdojë të jetë pjesë e Superligës turke, pasi ka arritur marrëveshje me skuadrën e Goztepe që interesohej për shërbimet e tij. Nuk bëhen të ditura shifrat e këtij transferimi dhe kontrata që do të nënshkruajë Cikalleshi me Goztepen por e rëndësishme është që lojtari do të vazhdojë të jetë pjesë e një klubi që luan në elitën e futbollit turk dhe që sezonin e fundit u rendit në vendin e gjashtë të tabelës. Cikalleshi largohet kështu nga Osmanlispor pas një sezoni në të cilin zhvilloi në total 14 ndeshje duke realizuar dhe



katër gola në të gjitha garat. Goztepe do të jetë skuadra e katërt e 28-vjeçarit në Superligën turke, pas Istanbul Basaksehir, Akhisar dhe Osmanlispor.

## Interi interesohet për Strakoshën

Skuadra e Interit ka shprehur interesim për portierin e Shqipërisë, Thomo Strakosha. Strakosha, 23-vjeçar, është titullar te Lazio. Portieri shqiptar ka kontratë me

Lazio deri në verën e vitit 2022. Por, siç raportohet në Itali, Interi është i gatshëm të paguajë dëmshpërblimin për ta pasur në skuadër.





# MOS E KRAHASONI SARRIN ME CONTEN

“Mjaft me krahasime. Nuk dua të flas për të kaluarën. Siç mund ta shikoni ne kemi një posedim të madh të topit dhe provojmë të kemi presion të lartë”, deklaroi Rudiger

Mbrojtësi i Chelseat Antonio Rudiger është i ngopur me krahasimet e shumta që janë bërë mes trajnerit të ri të klubit londinez Maurizio Sarri dhe atij të kaluarit Antonio Conte. Reprzentuesi gjerman kërkon të mos bëhen krahasime, duke dashur të përqendrohet vetëm në të tashmen, pas një fillimi të mirë të edicionit të ri. Antonio Rudigerit nuk po i pëlqejnë krahasimet që po bëhen mes trajnerit të ri të Chelseat Maurizio Sarri dhe atij të kaluarit Antonio Conte. Chelsea e ka filluar në mënyrë të shkëlqyeshme edicionin e ri në Premierligë, duke grumbulluar të gjitha pikët e mundshme nga tri javët e para. Kjo gjë ka bërë që të fillohen krahasimet mes stilit të futbollit të



luajtur nga Sarri dhe atij të Contes. Por Rudigerit, i cili ka luajtur çdo ndeshje deri më tani nën urdhrat e ish-trajnerit të Napolit, nuk i pëlqejnë krahasimet dhe dëshiron të përqendrohet në të tashmen. Sarri ka bërë ndryshime të shumta në “Stamford Bridge” që prej ardhjes së tij, duke zhvilluar një lojë sulmuese për dallim nga paraardhësi i tij Conte. “Mjaft me krahasime. Nuk dua të flas për të kaluarën. Siç mund ta shikoni ne kemi një posedim të madh të topit dhe provojmë të kemi presion të lartë”, deklaroi Rudiger. “Ndeshje pas ndeshjeje mendoj se po përmirësohem dhe

## MOURINHO S'DUHET TË SHKARKOHET

Ish-futbollisti i Manchester Unitedit, Bryan Robson thotë se gjigandi anglez nuk duhet ta shkarkojë nga detyra Jose Mourinhon. E ardhmja e portugezit në krye të “dajve të kuq” është vënë në dyshim pas dy humbjeve nga tre ndeshjet e para në ligën angleze. Robson, i cili ka luajtur 345 ndeshje për gjigandin anglez gjatë periudhës 1981-1994, mendon se atij duhet t'i jepet kohë për të bërë punën e tij. “Është shumë e thjeshtë. Një pjesë e vogël e tifozëve të klubit do të kërkojnë kokën e trajnerit pas disa rezultateve të dobëta dhe shpesh ata dëgjojnë më së shumti”, deklaroi Robson.

ky është qëllimi ynë. Para pushimit ndërkombëtar ne do të provojmë t'i fitojmë të gjitha ndeshjet dhe pastaj do të kthehemi dhe të vazhdojmë përpara. Në fund të ditës tri pikët janë më të rëndësishme, sepse paraqitet do të vijë me kohën. Nëse do ta shihja ndeshjen (ndaj Newcastle Unitedit) dhe ndaj Arsenalit në pjesën e parë dhe në

20 minutat e fundit, ne jemi duke u përmirësuar. Por, për mua dhe për të gjithë tri pikët janë të rëndësishme”, shtoi reprezentuesi gjerman.

Chelsea startoi ndaj Newcastle Unitedit me atë që mund të jetë zgjedhja e parë, me Sarri, i cili e filloi takimin për herë të parë me Eden Hazardin, ndërsa Mateo Kovacic luajti para Ross Barkleyt. Hazard ishte vendimtar në këtë takim dhe paraqitja e tij u shpërblye me gol falë penaltisë së realizuar.

“Mendoj se për trajnerin nuk ishte një zgjidhje e lehtë, sepse në sulm ne kemi lojtarë shumë kualitativë dhe sigurisht Eden është njëri prej tyre. Por ne kishim Willianin në bankinë. Nuk është e lehtë për trajnerin, por është mirë që të kesh shumë, shumë opsione. Konkurrenca sjell më të mirën nga të gjithë. Kjo është një gjë e mirë. Për sulmuesit është e mirë sepse ne mbajmë topin më shumë. Është gjë e mirë për këta lojtarë. T'i bësh këta lojtarë që të mbrojnë nuk është fuqia e tyre, sidomos për Edenin. Por lojtarët si N'Colo dhe Mateo janë një përzierje e mirë. Këta lojtarë mund të sulmojnë dhe mund të mbrojnë gjithashtu”, u shpreh ai.

Publicitet



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 20 të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018) të neneve 18 dhe 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016, 142/2016 dhe 11/2018), dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/2015”), Agjencia e Administratës publikon,

**SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 02/2018 - M**

për punësim në „Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë“ për vendet e punës në vijim

### 1. Këshilltar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të gjithë personave të tjerë

- Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
  - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet plotësuese:

- të kryer shkallën VII/1 ose 240 kredi sipas ECTS, Shkenca juridike ose Punë sociale dhe politikë sociale
- 3 vjet përvojë pune në profesion
- Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.387,00 denarë

### 2. Bashkëpunëtor i lartë për promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut

- Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
  - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet plotësuese:

- të kryer shkallën VII/1 ose 180 kredi sipas ECTS, Shkenca juridike ose shkenca politike ose sociologji
- më së paku 3 vjet përvojë pune nga sfera e lirive dhe të drejtave të njeriut në shërbimin administrativ ose në sektorin qytetar
- Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 23.483,00 denarë

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 10 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatët janë të obliguar fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim, si dhe për afatet dhe mënyrën e dorëzimit të dokumenteve të nevojshme lidhur me vendin e punës për të cilin paraqiten. Informacione shtesë për shpalljen: Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 20 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë dhe incizohet.

Kandidatët në provimin administrativë do të kenë 60 pyetje nga kompetenca e Avokatit të popullit, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Procedura administrative dhe Kontestet administrative.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të. Dëshminë për nënshkrimin dhe dëshminë për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, janë dokumente të cilat duhet të bashkëngjiten gjatë aplikimit



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 20 të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018) të neneve 18 dhe 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016, 142/2016 dhe 11/2018), dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/2015”), Agjencia e Administratës publikon,

**SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 03/2018 - M**

për punësim në „Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë“ për vendet e punës në vijim

### 1. Udhëheqës i njësive për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet plotësuese:

- të kryer shkallën VII/1 ose 300 kredi sipas ECTS, Shkenca juridike ose shkenca ekonomike ose shkenca organizuese dhe menaxhim (menaxhment)
- 4 vjet përvojë pune në profesion, ku 1 vit në shërbimin administrativë

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 28.303,00 denarë

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 10 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatët janë të obliguar fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim, si dhe për afatet dhe mënyrën e dorëzimit të dokumenteve të nevojshme lidhur me vendin e punës për të cilin paraqiten.

Informacione shtesë për shpalljen: Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 20 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë dhe incizohet.

Kandidatët në provimin administrativë do të kenë 60 pyetje nga kompetenca e Avokatit të popullit, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Procedura administrative dhe Kontestet administrative.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Dëshminë për nënshkrimin dhe dëshminë për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, janë dokumente të cilat duhet të bashkëngjiten gjatë aplikimit



JUVENTUSI IA MERR ZEMRËN ISH LOJTARIT TË REALIT

# LA PORTUGALINË PËR JUVENTUSIN

Ylli portugez ka refuzuar të bashkohet me kombëtaren për tu stërvitur më tepër për ndeshjet e ardhshme të Zonjës së Vjetër. Cristiano do t'i humbasë ndeshjet me Kroacinë dhe Italinë



Që kur u bë pjesë e Juventusit në mendjen e Cristiano nuk është askush tjetër. Ronaldo ka refuzuar të grumbullohet me Portugalinë për tu stërvitur më tepër dhe të jetë sa më në formë për bardhezinjtë e Torinos. Ylli portugez nuk dëshiron të pauzojë dhe dëshiron që të për-

fitojë nga ndërprerja e kampionateve për shkak të ndeshjeve me kombëtarët përkatëse. Këtë vendim të 5 herë fituesit të Topit të Artë e ka vlerësuar shumë edhe trajneri i Zonjës së Vjetër, Allegri. Gjithashtu edhe të gjithë italianët dhe fansat e klubit janë shumë të këna-

qur me këtë vendim. Përveç që do ta humbasë ndeshjen miqësore me Kroacinë, Ronaldo do të mungojë edhe në përballjen e parë të Nation League me përfaqësuesen e cila do të luhet me 10 shtator në Lisbonë me Italinë. Vija mbrojtëse e Juventusit e cila përbëhet nga Bo-

nucci dhe Chiellini do të jenë disi më të qetë pasi që kolegu i tyre do të mungojë në atë ndeshje. Forca kryesore e portugezëve nuk do të jetë i gatshëm t'i ndihmojë atyre, sepse dëshira kryesore e ish lojtarit të Realit është të fitojë sa më shumë me Juventusin.



## Wilder nuk tërhiqet, i gatshëm për luftë

Deontay Wilder e konfirmon se nuk do të tërhiqet dhe me çdo kush to të përballet me Tyson Fury. Dy boksierët me shumë gjasa do të ndeshen në muajin nëntor në Las Vegas, sfidë kjo e cila do të jetë e vlefshme për titullin kampion bote në kategorinë ËBC për peshë të rënda. Ky titull mbahet aktualisht nga Wilder. "Dua të konfirmoj se unë nuk kam ndryshuar mendjen dhe se me çdo kusht dueli me Fury do të zhvillohet. Kjo do të jetë një luftë që do ta pasurojë secilin nga ne të dy. Unë nuk kam qëllim t'i fitoj vetëm paratë. Ky do të jetë një moment kur do ta poshtëroj kundërshtarin tim në ring dhe të gjithë ata shikues që do ta ndjekin", tha Wilder. Asnjëri nga këta dy boksierë nuk e ka shijuar humbjen në karrierën profesionale si boksier. Wilder numëron gjithsej 40 fitore ndërsa Fury ka 26 fitore. Boksieri nga Britania pritet që të fitojë rreth 20 milionë dollarë nga kjo super përballje gjigantësh. E vetmja gjë e cila ka mbetur të përcaktohet është data se kur do të zhvillohet, me 7 apo me 15 nëntor.

Publicitet

## Reali gjen zëvendësuesin e Ronaldos

Nga Spanja raportojnë se Real Madridi e ka gjetur zëvendësuesin e Cristiano Ronaldos. Bëhet fjalë për panamezin Mariano Diaz. 25 vjeçari është prodhim i shkollës së futbollit të Real Madridit, por që u shit në Lyon me të drejtë blerje para një viti. Shuma që i kushtoi klubit francez për ta blerë ishte 8 milionë euro, ndërsa gjigantit spanjoll do t'i kushtojë afro 25 deri në 30 milionë euro për ta rikthyer në shtëpi. Perez duket se më në fund do t'ia plotësojë dëshirën teknikut të ri Lopetegui për të sjellë në ekip një lojtar cilësor. Diaz ishte pjesë e klubit madrilen vitin e kaluar por që nuk kishte shumë hapësirë për ta shfaqur kualitetin e tij pasi që në ekip kishte shumë yje si Cristiano Ronaldo, Bale, Benzema, Isco, Asensio e të tjerë.

## Henry thotë se Guardiola e mësoi të luante futboll

Të stërvitesha nën urdhrat e Guardiolas ishte sikurse të rikthehesha përsëri në shkollë. Thierry Henry u largua nga Arsenali në vitin 2007 për tu bashkuar me Barcelonën një vit para se Pep të merrte timonin e skuadrës. Francezi u bashkua me katalanasit për shumën e 24 milionë eurove. Futbollit të cilin e zhvillonte Guardiola bëri që Henry në moshën 30 vjeçare ta kuptojë futbollin e vërtetë, edhe pse kishte shumë vite që po luante si futbollist profesionist. "Futboll mësova të luaj përsëri në moshën 30 vjeçare. Guardiola është një profesor i shkëlqyeshëm. Ai din gjithçka dhe të mëson çfarë të bësh kur kundërshtari e ka topin dhe kur shoku juaj i skuadrës e ka topin", është shprehur Henry në intervistën për Sky Sports. Sezo-



nin e parë në Barcelonë francezi ishte nën urdhrat e trajnerit holandez Fank Rijkaard. Deri sa ishte pjesë e katalanasve fitoi shumë trofe. Ligën e Kampionëve, dy herë titullin e La Ligas, një titull në Copa Del Rey, trofeun e Kupës së Botës për Klube, trofeun e Superkupës së Evropës dhe atë të Spanjës.

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk  
info@gostivari.gov.mk  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-53/7  
27.08.2018 vit  
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

### LAJMËRIM

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë se për Projektin Arkitektonik-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1** -Komuna e Gostivarit, Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizim e:

### PREZANTIMI PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin Arkitektonik-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1** Komuna e Gostivarit që i përfshin këta kufij:

- Nga ana veriore me rrugën ekzistuese
- Nga ana lindore me rrugën për f. Debresh dhe zonë industriale
- Nga ana jugore me rrugë ekzistuese
- Në anën perëndimore me rrugë ekzistuese

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit me dt. **05.09.2018 (e mërkurë) në ora 13:00.**

Projekti Arkitektonik-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1** -Komuna e Gostivarit do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit që zgjatë 5 ditë pune prej **05.09.2018** deri **11.09.2018** çdo ditë pune prej orës **08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik mund të parashtrajnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e -urbanizëm.

Kryetari i Komunës  
Arben Taravari



EMOCIONE TË SHUMTA NË TENIS, VËSHTIRËSI PËR NOVAK DJOKOVIC E SHARAPOVA

# DJOKOVIC DHE FEDERER VAZHDOJNË TUTJE

Nole dhe Federer vazhdojnë tutje për tu bashkuar me Rafa Nadal. Dy ikonat botërore fituan përballjet me kundërshtarët. Tek femrat vetëm Sharapova hasi në probleme ndryshe nga Garcia

Në raundin e parë të US Open, tenistët favoritë vazhdojnë të triumfojnë. Novak Djokovic dhe Roger Federer kanë vazhduar tutje duke iu bashkangjitur Rafael Nadalit. Tenisti serb ka korrur fitore ndaj hungarezit Fucsovics 3:1, në përballjen e cila zgjati 3 orë. Raundin e dytë Djokovic do të ketë si kundërshtar amerikanin Sandgren. Në anën tjetër Federer e ka loji lehtë testin kundër japonezitet



Nishioka me rezultat të përgjithshëm 3:0. Zvicerani ndeshjen e ardhshme do ta zhvillojë kundër francezitet Paire, i cili ndodhet në vendin e 56 në botë. Ndeshje jo të vështirë kishte edhe Alex Zverev. Ky i fundit e shkatërroi Peter Polanskyn në 3:0 për 1 orë e 37 minuta.

Tek femrat ndeshje të komplikuar kishte rusja Maria Sharapova kundër tenistes zvicerane Schnyder. Seti i parë u mbyll me rezultat 6:2, seti i dytë vazhdoi në "tiebreak" ku në fund triumfuese doli përsëri Sharapova. Në raundin e dytë përballjen do ta ketë me rumunen

Cirstea. Caroline Garcia humbi vetëm 4 lojë përballë britanikes Konta. Dominim total për Garcian e cila e mbylli takimin për 1 orë e 17 minuta. Gjithçka që pritet nga tenisi janë emocionet nga turneu amerikan "Grand Slam" i fundit për vitin 2018.



## Cikalleshi nënshkruan me Goztepen

Goztepe rrëmben Sokol Cikalleshin nga Osmanlispori. Sulmuesi i kombëtares shqiptare i cili zhvilloi gjithsej 14 ndeshje dhe shënoi vetëm 4 gola në të gjitha kompeticionet, ka ndërruar klub për tu bashkuar me Goztepen. Këtë gjë e bëri të ditur "Ajansspor" por gjithashtu edhe mediat tjera turke të cilat ishin në vëzhgim të situatës së bomberit. Shifrat për të cilat është blerë sulmuesi nuk janë bërë të ditura ende për publikun. Futbollisti nga Kavaja do të vazhdojë të jetë pjesë në elitën e futbollit turk, në një klub i cili sezonin e kaluar përfundoi në vendin e gjashtë. Sokol Cikalleshi nuk arriti që të bëjë një dyshe perfekt me ish futbollistin e Gozteses, Demba Ba, ku ky i fundit u transferua përsëri në Kinë te klubi Shanghai Shenhua. Deri tani Sokol Cikalleshi ka ndërruar katër skuadra në kampionatin turk. 28 vjeçari ishte pjesë e Istanbul Basaksehirit pastaj kaloi tek Akhisar dhe skuadra e parafundit Osmanlispor. Goztepe do të ketë një forcë të madhe në repartin sulmues me bomberin kuq e zi.

## Leonardo dhe Maldini takohen me agjentët e futbollistëve

Lajmet e fundit nga Milano thonë se Mino Raiola është takuar me Leonardon dhe Paolo Maldinin për të biseduar për të ardhmen e Donnarummas. Sipas "La Repubblica" Leonardo dhe Maldini kanë shprehur dëshirën për tu takuar me të gjithë menaxherët e lojtarëve të tyre. Disa ditë më parë u takuan me agjentin e Ricardo Rodriguezit dhe tani e njëjta gjë do të ndodhë me Mino Raiolan, agjent i Abates, Donnarummas dhe Bonaventuras. Portieri i kuqezinjve nuk e ka nisur mirë sezonin

e ri ku kishte shumë kritika si nga mediumet e po ashtu edhe nga tifozëria. Paraqitja e tij kundër Lazio nuk ishte edhe aq për tu lavdëruar. Portieri i sapo ardhur në Milano, Reina, ka filluar ti japë dridhje Donnarummas që siç duket nuk e ka vendin e sigurt. Zëvendësuesi ideal i Gigit do të ishte spanjollit. Gjëja kryesore që do të bëjnë Leonardo dhe Maldini është ta rikthejnë vetëbesimin tek xhevahiri i skuadrës, portieri Donnarumma, pas një starti të keq në Seria A.



## Doncic i mungon Sllovenisë në kualifikime

Sllovenia nuk do ta ketë Luka Doncic për kualifikimet e Kampionatit Botëror. Tekniku Rade Trifunovic nuk mund të llogarit në basketbollistin më të mirë të ekipit për ndeshjet që do të luhen në shtator me Letoninë dhe Turqinë. Mungesë tjetër për Slloveninë do të jetë edhe Klemen Prepelicin të cilin klubin madrilen nuk e ka liruuar. Në "Grupin I" ku gjenden Ukraina, Spanja dhe Mali i Zi ndodhet po ashtu edhe Sllovenia.

Sllovenët gjenden në pozitë tejet të vështirë para fillimit të raundit të dytë të kualifikimeve. Kampionët e Evropës për momentin gjenden në vendin e fundit në tabelë me tetë pikë të grumbulluara. Ukraina dhe Mali i Zi i kanë të grumbulluara nga nëntë, Turqia dhe Letonia i kanë nga dhjetë ndërsa Spanja është lider i padiskutueshëm me 12 pikë. Vitin e ardhshëm ku do të mbahet Kampionati Botëror në basketboll do

të kualifikohen tre skuadrat më të mira të grupit. Lojtarët të cilët kanë marrë ftesë nga Sllovenia janë: Matij Rebec, Edo Muriç, Aljaz Bratec, Jakob Cebasek, Ziga Dimec, Urban Durnik, Gregor Glas, Miha Lapornik, Blaz Mahkovic, Blaz Mesicek, Gasper Vidmar, Luka Voncina, Sasha Zagoraç kurse Vlatko Cançar, Gregor Hrovat, Luka Rupnik, Anthony Rendolf dhe Juri Mançura do të bashkohen me skuadrën me 9 shtator.





**DASHI** 21. mars - 20. prill  
 Ka disa keqkuptime të cilat janë shtuar dhe për këtë arsye, nuk keni pasur kohë të mendoheni për lodhjen e akumuluar gjatë javëve të fundit. Do të jeni shumë të zënë me punë, por në këtë moment duhet të mundoheni që të përcaktoni më qartë çështjet më urgjente dhe të pushoni më shumë.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
 Kjo ditë do ju gjejë të çlodhur dhe optimist dhe kjo edhe në sajë të lajmeve të mira të cilat do ju lejojnë që të punoni me më shumë qetësi. Në dashuri, këshillohet që të jeni më spontan.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
 Mundohuni të jeni të kujdesshëm dhe të kontrolloni më mirë emocionet tuaja. Kjo pasi vetëm nëse tregoheni diplomat do të arrini të shmangni disa konflikte të ndezura në familje ose në punë.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
 Duhet të qartësoni mirë se cilat janë aktivitetet që keni në plan të zhvillonin këtë vjeshtë. Duhet të përcaktoni mirë prioritetet tuaja dhe sfidat që duhet të kaloni. Në dashuri duhet të jeni më të sigurtë dhe të vendosur.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
 Duhet të mundoheni të frenoni sa më shumë impulset tuaja, pasi në këtë moment ka disa diskutime të cilat duhet të zgjidhen me kujdesin maksimal. Zhvillime interesante dhe pozitive do të ketë në dashuri.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
 Parashikohet një mesjavë interesante për të ripërkufizuar disa vendime të marra në të kaluarën. Kjo e mërkurë ju fton të planifikoni deri në detaje projekte të reja të cilat keni ndërmend që ti çoni përpara gjatë muajve të ardhshëm. Në dashuri mund të rigjeni stabilitetin.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
 Në këtë moment po mundoheni ende që të përshatani me disa ndryshime që kanë ndodhur në raportet tuaja. Do të jeni të tensionuar, por kjo gjë nuk duhet t'iu pengojë në rigjetjen e qetësisë dhe harmonisë që keni humbur prej kohësh. Çështjet e biznesit janë mjaft të favorizuara.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
 Ka disa tensione të cilat nuk do ju lejojnë që të jetoni me qetësinë e duhur disa lidhje të nisura prej pak kohësh. Duhet të merrni më shumë kohë për të rigjetur sigurinë dhe për të sqaruar të gjitha dyshimet tuaja. Në vendin e punës do të jeni mjaft karizmatik.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
 Mund të merrni disa mesazhe të dyshimta nga një person që e njihni prej kohësh. Mundohuni të qartësoni ndjenjat tuaja dhe të mos jeni shumë impulsiv. Duhet të mateni mirë, para se të bëni disa shpenzime.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
 Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të jeni tejet aktiv dhe të qetësuar nga pikëpamja emocionale. Parashikohen konfirmime të rëndësishme për të zyrtarizuar një histori të rëndësishme dashurie.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
 Gjatë kësaj dite parashikohen disa zgjedhje të rëndësishme të cilat do ju lejojnë që të pranoni ose jo, një rol të rëndësishëm profesional. Kjo e mërkurë parashikohet mjaft pozitive nga pikëpamja sentimentale, ku mjaft të favorizuara janë takimet e reja.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
 Përpiguni të planifikoni një arratisje romantike ose disa momente për të kaluar në qetësi me familjen ose partnerin/en. Ka disa negociata në zhvillim të cilat ju bëjnë nervoz. Megjithatë mundohuni të mos dekurajoheni, pasi parashikohen përgjigje të mëdha.



KOHA	TË BËRIT ATEST SH)	KOLONIA MBRËTERORE THEMELUESE E QYTETIT NË FOTO	NDJAFOLJE, NDOKUND	ANTON PASHKU	LYM, LLUM	KOHA	REGJISORI SPELLING KËNGË E TUNËS	Mensur Mamuti	AKTORI ANGLEZ (SVANSTON)	SHTETI AUSTRALIAN, KRYEQYTETI, I TË CILUT ESHITË QYTETINË FOTO	BANOR I KRYEQYTETIT TË KAZAKISTANIT
BUDALLA, IDIOT (TURQ)						PLUHUR KOZMETIK					
QYTETI I LASHTË ROMAK (PONT, ANADOLL)						AKTORJA AM. ANDERSON					
I PARI I NJË FISË TË POPËLIT ARABË										ILIRIANA SULKUQI	
SH				VDEKJA ZHDUKET						KLLAPI, PËRÇARTJE	JATAKU
ESTUHISHME										SHUMA E LARGUAR NGA VENDI	
TANTALI			URANIUMI			KUZHINA PUBLIKE PRANE XHAMISE					
SHPREHJE ALGJEBRIKE (SH. PASHQ)			OLIVIA LI			MONEDHA E UNIONIT EVROPAN					
B							FUTBOLLISTI KOSOVAR, ADEMI				
QYTETI NË FOTO, I THEMELUAR NË KËTË DATE							RAJON ADMINISTRATIV I VEÇANTË			POSEDON	
EDA ZARI				FRYMË AJRI SUECIA						NDJAFOLJE PYETËSE	
BËRA TESTIM							NGJYRA MË E FORTË NË LETRABOXHOZI AMPERI				
										NEVOJË PËR TË NGRËNE	

ZGJIDHJET: EVA, LIS, IKT, ATA, ARON, ABDAL, PUDRA, TRIPOLIS, IS, SHEIK, MORTJA, STUHNORE, SH, TA, U, IMARET, BINOME, ALMIR, MELBURNI, KA, EZ, ERA, ADUT, TESTOVA, URL.

## Sudoku

*shumë i lehtë*

9			2		1			5
		4				3		
	5		7		4		6	
1		2		8	6	5		7
			1		2			
5		6	3	4		2		8
	1		8		5		2	
			9			7		
7			6		9			3

*mesatar*

7	9							5
	1				7			3
5			3		9			
1			4			8		
			8		6		2	
		9			5			4
			7		6			
			5				8	7
2	5					4		6

Shumë i lehtë: 968231475, 274568391, 351794862, 132986547, 487152639, 596347218, 613875924, 829413756, 745629183, Shumë i vështirë: 793648125, 816257943, 542319678, 135472869, 478963251, 629185734, 384796512, 961524387, 257831496.



## Lufta Turqi-SHBA: TRT-ja nuk do të shfaqë më filma amerikanë me kauboje

Stacioni televiziv shtetëror i Turqisë - TRT, nuk do të shfaqë më filma amerikanë me kauboje. Vendimi ka lidhje me krizën aktuale midis SHBA dhe Turqisë, thonë mediat turke. SHBA-ja ka kërkuar lirim e qytetarëve që mbahen të burgosur në Turqi, përfshirë pastorin ungjillor Andrew Brunson dhe kanë vendosur sanksione ndaj dy diplomatëve turq dhe tarifa për importet e metaleve nga Turqia. Turqia është kundërpërgjigjur me masa të ngjashme. Lira turke pati një rënie të ndjeshme javët e fundit si rezultat i kësaj situatë. "Filmat me kauboje do të zëvendësohen nga produksione vendase të mbështetura nga Ministria e Kulturës", raportojnë mediat lokale.



## Hëngri sushi, i presin dorën

Ka qenë tragjike ajo që i ka ndodhur një të moshuari. Një burrë 71-vjeçar pagoi një çmim të lartë për sushin që ai konsumoi, pasi përfundoi në spital ku i hoqën dorën së bashku me parakrahun. Ngjarja ka ndodhur në Korenë e Jugut. 71 vjeçari ka përfunduar në spital, 12 orë, pasi kishte konsumuar sushi. Sipas mjekëve i moshuar ka pësuar një infeksion i cila i ka krijuar flluska të mëdha në dorën e tij. Ata thanë se infeksion është shkaktuar nga produktet e detit të cilat kanë qenë të papërpunuara. Mjekët i kanë hequr dorën dhe parakrahun, pasi ato ishin të infektuara dhe mund ti rrezikonin jetën.



## Agjenti i CIA-s: Unë e vrava Bob Marley



Edhe pse kanë kaluar tre dekada e gjysmë nga vdekja e Bob Marleyt, vazhdohet ende të flitet jo vetëm për muzikën e tij por edhe për largimin e parakohshëm nga jeta. E teksa versioni zyrtar i vdekjes së legjendës së muzikës Reggae është diagnostifikimi me sëmundjen melanoma malinje që kishte prekur gishtin e madh të këmbës së tij, të shkaktuar gjatë një ndeshje futbolli, së fundmi vjen një version tronditës. Bëhet fjalë për rrëfimin e Bill Oxley, ish-agjent i CIA, i cili po rishkruan historinë e vdekjes së Marley-t, duke pretenduar se e ka vrarë ai vetë. 79-vjeçari ka

pohuar se e ka kryer vrasjen e Marley në mesin e 17 vrasjeve të profileve të larta që i kishte në listë qeveria amerikane midis viteve 1974 dhe 1985. Teksa rrëfen edhe mënyrën e vrasjes, Oxley tregon se i ka shkuar në shtëpi Bob Marleyt dhe i është prezantuar si një fotograf i "New York Times", i ka dhuruar një palë atlete në shenjë respekti, brenda së cilave kishte një gozhdë e cila ishte me virusin e kancerit. CIA kishte mohuar më parë ndonjë përfshirje në vdekjen e Marleyt, ndërkohë që tani nuk pranon të flasë rreth pohimeve të ish-agjentit të saj.

## Tre copë çokollatë në muaj ul rrezikun nga sulmi në zemër

Konsumimi i normal i çokollatës mund të jetë i mirë për shëndetin, kanë thënë hulumtuesit. Hulumtuesit kanë gjetur se tre copë çokollatë në muaj ul rrezikun nga sulmi në zemër për 13 për qind. Më shumë se 900 mijë persona janë të prekur nga sulmi në zemër në Britani të madhe dhe gati një e treta vdes gjatë një viti nga sulmi në zemër. Hulumtuesit besojnë se përbërësit natyral të çokollatës, të quajtur flavonoide ndihmojnë enët e gjakut dhe reduktojnë inflamacionin.

Por ata këshillojnë se tejkalimi i konsumimit të çokollatës mund të ndikojë për të keq në shëndet për shkak të përmbajtjes së sheqerit. Hulumtuesit kanë gjetur se konsumimi ditor i çokollatës rrit rrezikun nga sulmi në zemër për 17 për qind. Për gjetjet e këtij hulumtimi janë analizuar pesë studime në të cilat janë përfshirë 575 mijë persona. Studimi është prezantuar në Munich gjatë konferencës së mbajtur nga Shoqëria Evropiane e Kardiologjisë.



8 - Gjenerali i Perandorisë Romake, Tiberi mund Dalmatët tek Lumi Batina.

435 - Patriarku i shkarkuar i Konstantinopojës, Nestori, që konsiderohet themelues i Nestorianizmit dëbohet nga Perandori bizantin Teodori II në një manastir në Egjipt.

881 - Beteja e Saucortit: Mbreti i Francës, Luigji III mund Vikingët.

1108 - Kurorëzohet si Mbret i Francës, Luigji VI, "I trashit".

1492 - Të gjithë hebrenjtë dëbohet nga Spanja.

1645 - Beteja e Alershajmit: Francezët mundin Bavarezët.

1914 - Flota franceze lundron për në Afrikën Veriore.

1914 - Turqia nënshkruan pakt ushtarak me Gjermaninë.

1940 - Trupat italiane pushtojnë Somalinë britanike.

1944 - Në kampin e përqendrimit Auschwitz-Birkenau mbyten me gaz 4,000 jevgji.

2004 - Rihapet piedestali i Statujës së Lirisë pas mbylljes së saj që nga 11 shtatori i vitit 2001.

108 njerëz vdesin çdo minutë në botë; çdo vit, kryesisht si shkaqe kryesore janë përcaktuar goditjet në tru dhe atak të zemrës.



Numërohen rreth 2700 gjuhë të folura me mbi 7000 dialekte në të gjithë botën. Gjuhët më të folura janë gjuha kinezishtja, spanjishtja, anglishtja dhe hindishtja.

Nëse kukullat Barbi do të ishin të vërteta, ato do të qenë shumë të dobëta për të patur fëmijë, dhe shumë jo proporcionale për të ecur drejt.



### NË DIELL

Biondja e zgjuar...

- Në cilin trup qiellor ke dëshirë të shkosh? - e pyet profesori studenten bionde!

- Në diell! - përgjigjet biondja!

- Në diell? Po nuk e di ti se sa të afroresh atje do të digjesh e shkrihesh nga nxehtësia?

- Pse budallaqe jam unë, sigurisht që atje do të shkoj natën!



Më pëlqen të dëgjoj. Kam mësuar shumë nga dëgjimi me kujdes. Shumica e njerëzve nuk dëgjojnë kurrë!  
**(Heminguej)**



KALENDARI HISTORIK 30 GUSHT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS